

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7567 E premte 22 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion Ditës

Takimi i dhjetë liderëve europianë të mbledhur këto ditë për të diskutuar "patatën e nxehtë" të azilantëve politikë doli me një rezolutë të ...
Vijon në faqen 20

Nga ILIR KALEMAJ

A mund të presë Shqipëria 600 mijë refugjatë?



Opinion Ditës

Pas vendimit të parlamentit holandez për të mos lejuar hapjen e negociatave midis Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, në Shqipëri kanë nisur ...
Vijon në faqen 21

Nga VINCENT TRIEST

Dështimi shqiptar solli moshapjen e negociatave



Dy ministrat e Brendshëm, takim kokë më kokë
Xhafaj në Berlin me homologun Seehofer: Gjermania, dritë jeshile negociatave

Sherr në Kuvend për integrimin, Basha: BE nuk i hap negociatat. Edhe Holanda thotë 'Jo'

Gjermania pritet t'i japë dritë jeshile integrimit europian të Shqipërisë. Kjo u konfirmua pas takimit që ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj pati në Berlin me homologun e tij, ministrin e Brendshëm Federal të Gjermanisë, Horst Seehofer: Takimit të delegacioneve përkatëse i parapriu një bisedë miqësore dhe konstruktive kokë ...
Në faqet 2-5

EMRAT/ QEVERIA MIRATON LISTEN E PERFITUESVE NGA FONDI I ALUIZNI-T

KOMPENSIMI, 1200 PRONARET QE MARRIN 732 MILIONE LEKE

Tokat e zëna nga "informalët", cilat janë familjet që përfitojnë në Tiranë, Vorë, Kamëz, Elbasan, Shkodër dhe në fshatrat turistike në bregdet



(Në foto) Ndërtime informale

Në faqet 11-15

PAGESA E KONTRIBUTEVE

ISSH, thirrje për emigrantët: Ja si të siguroheni për pensionin

Në faqen 9

2 KATEGORITË

SHBA: Vizat për çiftet, aplikimet për të fejuarit dhe të martuarit

Në faqen 8

DIALOGU KOSOVE-SERBI

Vuçiq: Jemi pro kompromisit, por jo presionit. Thaçi: Koha për pakt historik

Në faqen 16

KORÇË

Vdekja e të riut në qeli, akuza ndaj policëve: Nuk i dhanë ndihmë

Në faqen 6

HAPET ÇESHTJA



Izet Haxhia fiton rigjykimin për vrasjen e Azem Hajdarit: S'kam faj

Në faqen 7

Durrës/ Destan Neziri: U bë gol dhe Hajriu u nervozua e na goditi mua dhe gruan

E plagosën me thikë, babai: E fal djalin

75-vjeçari në spital: Nga fëmija ç'nuk pret. Nusja po na mbronte

Nga KLODIANA HAXHIAJ

DURRËS-Fëmija të bën atë që nuk ta pret mendja. Ishim duke parë një ndeshje të Botërorit dhe në momentin që u bë gol, djali u nervozua keq dhe na goditi mua dhe gruan. Ngjarja ndodhi shumë shpejt. Por pavarësisht kësaj,



unë nuk e hedh poshtë tim bir se ai bëri një gabim. Unë jam prind e një prind për fëmijën e ka zemrën të madhe, ndaj do e fal atë". Kështu deklaroi dje nga spitali i Durrësit ku ndodhet i shtruar, 75-vjeçari Destan Neziri, i cili pasditen e së mërkurës u godit ...

Në faqen 6

INTEGRIMI REAGIMET

Ministri i Brendshëm, kokë më kokë në Berlin me kolegun: Luftë krimin të organizuar

Xhafaj takon homologun gjerman: Dritë jeshile negociatave me BE

Seehofer: Kancelarja do ndërmarrë këtë hap

Gjermania pritet t'i japë dritë jeshile in tegrimit evropian të Shqipërisë. Kjo u konfirmua pas takimit që ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj pati në Berlin me homologun e tij, ministrin e Brendshëm Federal të Gjermanisë, Horst Seehofer. Takimit të delegacioneve përkatëse i parapriu një bisedë miqësore dhe konstruktive kokë më kokë e të dy ministrave. Që në krye të herës, Seehofer, në cilësinë e ministrit të Brendshëm Federal, por edhe si president i Partisë CSU, deklaroi se, "i ka dhënë dritën jeshile Kancelares Federale dhe Ministrisë së Jashtme për hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE". Në referim të mbështetjes së vazhdueshme të Gjermanisë ndaj vendit tonë, ministri Xhafaj evokoi veprimtarinë e ish-kryeministrit të Bavarisë, Franz Josef Strauss, i cili rreth 35 vjet më parë bëri përpjekje për t'i hapur Shqipërisë një dritare drejt Evropës. "Sot, me progresin e gjithanshëm, është momenti i duhur që Gjermania të jetë në pararojë të shteteve që mbështesin Shqipërinë në rrugëtimin e saj për t'iu bashkuar familjes evropiane", u shpreh ministri Xhafaj.

Gjatë takimit, të dy ministrat diskutuan mbi çështjet aktuale si migracioni i paligjshëm, çështjet e menaxhimit dhe kontrollit të kufirit, si dhe atë të azilkerkuesve shqiptarë në Evropë. Gjithashtu, ministri Xhafaj e njohu ministrin Seehofer me arrijtjet dhe progresin që ka bërë Shqipëria në rrugën e integritimit evropian, veçanërisht në luftën kundër krimin të organizuar, luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave. Në këtë kontekst, ministri Xhafaj evidentoi bashkëpunimin e shkëlqyer me Gjermaninë dhe veçanërisht me autoritet policore gjermane, i cili ka rezultuar në hetime dhe operacione



Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj me homologun e tij, Horst Seehofer, dje në Berlin

Bushati: Maturia dhe qëndrimi i ndershëm i partnerit tonë janë të mirëpritur e orientues

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati falënderoi dje, Kancelaren gjermane Angela Merkel dhe qeverinë gjermane për konfirmimin e mbështetjes ndaj Shqipërisë. "Qartësia pro-zgjerimit, maturia dhe qëndrimi i ndershëm i partnerit tonë janë të mirëpritur e orientues përgjatë këtij rrugëtimi sfidues që bazohet te logjika e kushtëzimit demokratik dhe e ndjekjes së vazhdueshme të progresit në reforma. Aktrimi grotesk i opozitës në Kuvend është një përpjekje e pafat, por e përsëritur për të bërë të zezen të bardhë!", tha Bushati.



të përbashkëta të suksesshme, si dhe me një numër operacionesh të përbashkëta, që janë në proces. Më tej, z.Xhafaj u ndal te problematikën që lidhen me luftën kundër terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Ministri

Seehofer shprehu, veç të tjerash, interes në lidhje me reformën në drejtësi dhe procesin e vettingut në polici, duke përgëzuar për hapat që po hidhen në këtë drejtim, gjë që do të çojë në konsolidimin e sistemit të drejtësisë në vendin tonë. Ministri

BASHKËPUNIMI

Ministri i Brendshëm gjerman, Seehofer u shpreh se, "do të bëjmë të gjitha përpjekjet që bashkëpunimi mes dy vendeve tona të konkretizohet më tej" dhe shtoi se shumë shpejt do të jetë në Tiranë.

Xhafaj i prezantoi homologut të tij një plan me 10 pika, i cili parashikon fushat e bashkëpunimit në nivel institucional dhe operacional.

Të dy ministrat ndanë të njëjtin mendim se implementimi i këtij plani do të ndikojë në konsolidimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve tona. Ministri Seehofer e priti me shumë kënaqësi dhe entuziazëm këtë propozim dhe garantoi se, "shumë shpejt do të njiheni me veprimet tona konkrete në lidhje me këto çështje". Në vijim, në funksion të thellimit të bashkëpunimit, ministri Xhafaj u shpreh se, "tashmë mes nesh ekziston besimi i duhur, ndaj i kërkojmë Gjermanisë të monitorojë dhe të mbështesë realizimin e objektivave dhe prioritetëve të Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit". Në mbyllje të takimit, ministri Xhafaj e ftoi homologun Seehofer për një vizitë zyrtare në Tiranë, ftesë që u prit me shumë kënaqësi nga ky i fundit.



Fleckenstein: E padrejtë të jepen negociata me kushte për kampe refugjatësh

Raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Knut Fleckenstein deklaroi dje, se ka sinjale të qarta, se Gjermania do të votojë për negociatave. "Nuk jepen negociata me vënje kushtesh për kampe refugjatësh, do të ishte e padrejtë", tha në intervistë me Deutsche Wellen, raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, socialdemokrati gjerman, Knut Fleckenstein.

Zoti Fleckenstein po afrohet finalja e debatit disa javor, do të hapen apo jo negociatat e anëtarësimit BE - Shqipëri?

Nuk mund të them saktë, sepse nuk jam anëtar i Këshillit të BE-së, por di që diskutohet, se ç'formë duhet të ketë vendimi përfundimtar, kjo vlen si për Shqipërinë ashtu edhe për Maqedoninë.

Pse po diskutohet ende, ku ka rezerva?

Ka disa rezerva, sidomos nga pala franceze, që Bashkimi Evropian duhet të reformohet njëherë vetë më parë, pastaj të bëhen hapa të tjerë. Mendoj se ky është një argument i gabuar, sepse negociatat nuk zgjasin disa ditë, por me vite dhe në këtë kohë mund të kryhen reformat tona të nevojshme për të pranuar vende të tjera.

Si vendos Gjermania? A është pro hapjes së negociatave?

Kam sinjale shumë të qarta nga Zyra e Kancelares dhe nga fraksioni se Gjermania do të thotë një "po" të qartë për negociatat.

Por, a mund të jetë një kusht tjetër, thënë ndryshe një dëshirë e BE-së, që Shqipëria të pranojë kampe refugjatësh në territorin e saj?

Për këtë nuk kam informacion, por edhe pyetja juaj të thotë, se në këtë samit do të trajtohen çështje të ndryshme, e ardhmja e eurozonës, si ta rregullojmë çështjen e migrimit, dhe për çështjen se si të biem dakord për hapat e tjerë në lidhje me Ballkanin Perëndimor. E në këtë kontekst mund të ketë gjithmonë kompromise mes 28 vendeve të Bashkimit Evropian, cilat dalin përtej kufijve të territorit në fjalë. Nuk mund ta pranojmë, por as nuk e përfytyroj dot, se nuk i njoh detajet.

Ka një plan për ngritjen e kampeve të refugjatëve jashtë BE-së, në media është përmendur Shqipëria dhe Libia. A është Shqipëria ndër këto vende, zyrtarisht qeveria nuk ka pranuar asgjë...

Në të vërtetë nuk njoh emra shtetesh që do të pyeten. Por për këtë vetëm mund të bësh kërkesë. Nuk e besoj, se kjo do të bëhet kusht për hapjen e negociatave, kjo do të ishte plotësisht e padrejtë.





Diskutime të gjata në parlamentin holandez, votojnë kundër 125 deputetë

Parlamenti i Holandës vendos: Jo çelje negociatash për Shqipërinë

Franca ende skeptike, "Der Standard": Opozita po lobon kundër

Darina Tanushi

Parlamenti i Holandës i ka thënë 'Jo' hapjes së negociatave për Shqipërinë. 125 deputetë nga shumica dhe opozita kanë votuar mbrëmë kundër çeljes së negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë, duke zvogëluar kështu mundësinë për të marrë një lajm të mirë më 28-29 qershor. Vendimi i parlamentit holandez për mocionin e paraqitur nga Komisioni për Çështjet me Europën është marrë dje pasdite pas diskutimeve të gjata, rreth një orë e 40 minuta mes përfaqësuesve të partive politike në këtë komision. Në përfundim, burime nga mbledhja thanë se mund të ketë një degëz të ngjashme në ditët në vijim. Në sallën e Komisionit për Çështjet e Europës ndodhej edhe ambasadorja e Shqipërisë në Holandë, Aida Sakiqi. Ndërkohë dje, gazeta holandeze "De Telegraaf" paralajmëroi votë kundër të Holandës në takimin e liderëve të vendeve të BE-së në Bruksel në 28 dhe 29 qershor. Në një shkrimin me titull "Holanda bllokoi pranimin e Shqipërisë në BE" thuhet se shumica e partive të parlamentit holandez janë kundër hapjes së negociatave dhe shkak për këtë janë bërë shqetësimet për krimin e organizuar dhe korrupsionin. "Shumica e partive të parlamentit holandez e dërgon qeverinë e Holandës në Bruksel me mesazhin e qartë për të mos votuar pro hapjes së negociatave. Shqipëria, vendi ballkanik i goditur nga varfëria u bë kandidat për anëtarësim në BE disa vjet më parë me miratimin e Dhomës së Përfaqësuesve. Komisioni Europian tani dëshiron të nisë negociatat për anëtarësim me Shqipërinë dhe Maqedoninë. KE madje përmend një vit në të cilin anëtarësimi duhet të jetë një fakt, 2025", shkruan gazeta.

Gazeta "De Telegraaf" citon ministrin e Jashtëm holandez, i cili deklaroi: "Ne kemi shqetësime serioze në lidhje me luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar - duke shtuar se - më shumë përparime duhet të bëhen në këto çështje". Megjithatë, ai ende nuk e mbyll derën për Shqipërinë. Partitë të deklaruara kundër hapjes së negociatave në parlamentin holandez janë 5, VVD, CDA, CU, PVV dhe PS 50Plus. Një prej deputetëve të CDA, Van Helvert



Parlamenti i Holandës dhe faksimile e vendimit të djeshëm

Presidenti i Republikës pritet nga zyrtarët hungarezë

Meta merr garancinë e Orbán: Hungaria do të bëjë çdo gjë për negociatat

Presidenti Meta i shprehu mirënjohjen Kryeministrit dhe kryeparlamentarit të Hungarisë për mbështetjen domethënëse e pa rezervë që i kanë dhënë Shqipërisë për çeljen e negociatave të anëtarësimit në BE. Gjatë takimit me Kryeministrin e Hungarisë, Viktor Orbán, ndërës vlerësoi raportet e mira mes vendeve shprehu besimin se rivendosja e linjës direkte ajrore midis kryeqyteteve të të dyja vendeve dhe hapja e Dhomës së Tregtisë së Hungarisë në Tiranë do të bëjnë që ky bashkëpunim të rritet ndjeshëm dhe që pas katër viteve Shqipëria dhe Hungaria ta festojnë 100-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me rezultate konkrete e



domethënëse. Kryeministri Orbán e siguroi Presidentin Meta për mbështetjen e vazhdueshme të qeverisë së tij për Shqipërinë dhe shqiptarët si dhe forcimin e mëtejshëm të miqësisë historike midis dy popujve. "E sigurova Shkëlqesinë e Tij se Hungaria është një nga mbështetëset kryesore të integritimit perëndimor të Shqipërisë, sidomos të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Hungaria

dhe ne personalisht do të bëjmë çdo gjë për ta përshtetur atë proces dhe t'ua bëjmë të qartë udhëheqësve evropianë se anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian nuk është i rëndësishëm vetëm për Shqipërinë. Nuk është i rëndësishëm vetëm për rajonin, por është bindja ime personale se është i rëndësishëm edhe për vetë BE-së, sepse Shqipëria si një vend i ri anëtar, mund t'i japë energji pozitive, ambicie dhe një shtytje të re Bashkimit Evropian, gjëra për cilat patjetër që kemi nevojë", tha Orbán. Edhe kryeparlamentari hungarez Kóvér e siguroi Presidentin Meta se Parlamenti hungarez do vijojë ta mbështesë Shqipërinë pa asnjë rezervë në aspiratën e saj evropiane.

Takimi Rama-Tsipras në korrik, hiqet "Çamëria" nga pakti mes dy vendeve

Mediat greke lajmëruan dje finalizimin e një marrëveshjeje mes Greqisë dhe Shqipërisë, përmes së cilës zgjidhen problemet e vjetra mes dy vendeve. Por sipas tyre, në këtë marrëveshje nuk përmendet fjala "Çamëri". Tashmë është bërë e qartë se dy palët janë dakord plotësisht për abrogimin e ligjit të luftës, por duket se për Çamërinë kanë rënë nën presionin e një pjese të politikës greke, që ia ka vënë këtë si kusht kryeministrit Aleksis Tsipras. Ka qenë zyra e kryeministrit grek, që ka shpërndarë në media detaje se fjala "Çamëri" nuk përmendet në marrëveshje. Ende nuk ka saktësim për marrëveshjen e detit, por ndërkohë në këtë marrëveshje fitet për njohjen e patenteve shqiptare dhe greke, heqjen e vullës apostile si dhe të drejtat e minoriteteve. Po nga media greke thuhet se kryeministri Edi Rama e Tsipras mund të takohen në Bruksel. Më pas, marrëveshja pritet të marrë firmat e Ramës dhe Tsipras në mesin e korrikut. Parashikohet që marrëveshja të nënshkruhet në ishullin e Korfuzit, citon "Report TV". Grupi negociator shqiptar ka kërkuar që marrëveshja të marrë miratimin e parlamentit grek e më pas të firmoset nga dy kryeministrit. Format i marrëveshjes do të mbajë si logo atë të Partneritetit Strategjik, ndërës Traktati i Miqësisë Shqiptari-Greqi do të rinovohet në vitin e ardhshëm. Ndërkohë dje, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati shkoi në Konferencën e Tretë për Siguri dhe Stabilitet, në Rodos. Aty ka pasur edhe një takim me homologun e tij, Nikos Kotzias. Në fjalën e tij, Bushati u ndal tek nevoja e bashkëpunimit mes vendeve, në përballjen me sfidat aktuale të sigurisë.



SHPALLJE ANKANDI
Datë 28.06.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com. Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Muharrem Hysen Greca: -Banesë dykateshe, me sipërfaqe totale 333.16 m², e ndodhur në zonën kadastrale 8150, Vetëdeklaruar pranë ALUJN4 - Tiranë Jug me nr. 428 datë 28.08.2006, adresës Rr. "3 Vëllezërit Konat", Tiranë. Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 4 730 083 (katër milionë e shtatëqind e nëntësheqerë mijë e tetëdhjetë e tre) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

FRANCA
Ndërsa Franca vijon të jetë skeptike lidhur me hapjen e negociatave të Shqipërisë në

BE. Shkak për këtë është korrupsioni në sistemin gjyqësor, ku sipas mediave franceze, reforma në radhë e prokurorëve dhe gjyqtarëve po nxjerr në pah të korruptuarit. Në një shkrim kushtuar gjyqësorit, "Der Standard" bën një përmblidhje të gjithçkaje ka ndodhur në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, ku deri më tani 19 gjyqtarë dhe prokurorë nuk kanë mundur të shpëjtojnë pasuritë e tyre dhe kanë dhënë dorëheqjen, ndërsa 7 janë shkarkuar nga detyra. "Megjithatë, ka rezistencë në shtet e BE kundër fillimit të bisedimeve të pranimit në BE me Shqipërinë. Kjo vjen kryesisht nga Franca, por edhe nga Danimarka dhe Holanda. Ndonëse këta të fundit kanë gjasa të kthejnë

kur të gjithë të tjerët po tërhiqen, është ende e mundur që Parisi të votojë kundër shqyrtimit të kapitujve të parë të BE-së për Shqipërinë në samitin e 28 dhe 29 qershorit", vijon shkrimi. "Udhëheqësi socialist Edi Rama gjithashtu ka disa miq të partisë në BE, sepse shumica e vendeve të BE-së qeverisen nga konservatorët. Opozita në vendin e vet, Partia Demokratike (PD), ashtu siç është ag e zakonshme në Ballkan, refuzojnë të përgëzojnë qeverinë dhe lobon në BE kundër fillimit të negociatave. Gjithashtu, në CDU dhe CSU ka njerëz që janë kundër bisedimeve të pranimit. Megjithatë, Merkel ka fjalën e fundit dhe kancelaria është në favor", thuhet në shkrimin e "Der Standard".

BLLOKIMI I SEANCES DEBATI

Valentina Madani

Kuvendi u shndërrua dje serish në një arenë debati, pasi kreu i opozitës, Lulzim Basha dha lajmin e keq nga Gjermania për çështjen e negociatave. Por socialist deklaruan të kundërtën, sipas tyre, Gjermania mbështet hapjen e negociatave me vendin tonë. Por në sallë shpërthyen të qeshurat, kur Basha tha se po të mos ishte ndërhyrja e opozitës, vendimi gjerman mund të kishte qenë më i keq. "Vendimi mund të kishte qenë edhe shumë më i keq, po mos kish të qenë për insistimin tonë si opozitë", deklaroi kreu i PD-së. Teksa kryeministri Rama dhe Taulant Balla qeshnin, Basha u shpreh: "Shikoni si zgërdhohen". Mes debatit dhe akuzave, kreu të PD-së iu përgjigj, kryetari i grupit parlamentar socialist Taulant Balla, i cili beson se Shqipëria do të marrë një "po" për negociatat ndërsa sqaroi raportet me Gjermaninë. "Të kesh për kryetar Lulin është sikur të kesh kryetar Babalen, Luli dhe Babalja sot janë njëloj dhe e vërteta është që aq keq e ke punën me Babalen sa ke dy seanca plenare që Babalen nuk e ke më pjesë të transmetimit në 'FB', sepse Babales i doli lëngu dhe lëngun Lul nuk e ku ta fusësh më. Qoftë qeveria e koalicionit të madh dhe qoftë qeveria gjermane mbështetën plotësisht hapjen e negociatave", tha z.Balla.

AKUZAT

Në parlament nuk munguan akuzat mes palëve, ndërsa Basha akuzoi: "Njëri prej atyre që zgërdhohen më shumë ka qenë në Gjermani para tri ditësh. Mbajeni mend këtë që po ju them, dhe ka porositur një Toyota Yaris, po ta kanë zbuluar Toyotën, o zgërdhimitar, bashkë me 1.5 mln euro të drogës brenda. Vazhdo qesh, do e shikosh çfarë do të tundi para hundës shumë shpejt. Përgjigje për këtë akuzë, dha Balla jashtë sallës së Kuvendit. "Di që kanë qenë nga PS, Mimi Kodheli, nga PD, Sali Berisha, Lulzim Basha. Nëse Saliu ka qenë me drogë në Toyota dhe e ka parë Lulzim i kjo është çështje e brendshme e PD-së, në kuadër të dueleve ndoshta ende të fshehura për lidhshipin e PD-së". Zaptimi i foltres nga Lulzim Basha, detyroi kryeparlamentarin Gramoz Ruçi, të ndërprejë dy herë seancën. Ky moment solli një reagim kritik të nënkryetarit të LSI Luan Rama, i cili la të kuptohet se pakënaqësi nuk ka vetëm për mënyrën se si po drejtohet Kuvendi, por dhe për sjelljen e Lulzimit Bashës. "Krijoni normalitetin e nevojshëm. Lironi foltoren të flitet siç flitet në një parlament normal", -u shpreh z.Rama. Por kjo deklaratë e tij, u zbut nga kryetari i grupit të LSI-së, Petrit Vasili. "Zoti Luan Rama kërkoi fare mirë të vazhdonim dhe kreu i PD të vazhdojë fjalën e tij pasi iu

Debatet, nga 'Tojota' me 1.5 milionë euro, drogë të 'fustanellat' dhe bllokimi i internetit

Diskutimet e pamundura në Kuvend, opozita godet tavolinat

PS me dy deputetë të LSI kalojnë projektligjet



"KAMPI", SHEHU: INICIATIVA AVENTURESKE

Deputeti i PD, Tritan Shehu foli dje për pretendimet se Shqipëria mund të pranojë 600 mijë refugjatë nga vendet e luftës si dhe vendimin e KE në fund të këtij muaji për hapjen ose jo të negociatave me Shqipërinë për anëtarësimin. Shehu tha se Shqipëria duhet të marrë përgjegjësinë e saj në lidhje me refugjatët, por brenda kapaciteteve që ka. Sipas tij, qeveria është e paaftë për të dialoguar me ndërkombehtarët për këtë çështje.



vu në dispozicion e gjithë koha e grupit të tij parlamentar", -theksoi z.Vasili.

BLLOKIMI

Pas ndërprerjes së parë prej 10 minutash, Kuvendi rinisi punimet, ndërkohë që kreu i PD-së, Lulzim Basha nuk u largua nga foltorja. Kryeparlamentari Gramoz Ruçi kërkoi të largohet e të ulet në vend e të mos pengojë punimet dhe rendin e ditës. Gjatë kohës që Ruçi po replikonte me Bashën për të ndërprerë fjalën, ish-kryem-

LSI, kundër bllokimit të foltres nga Basha

Luan Rama: Nuk ka normalitet, Ruçi të zbatojë rregulloren

Lëvizja Socialiste për Integrim duket se nuk është në të njëjtën mendje me PD-në për skenarin e përsëritur tashmë disa herë në parlament për bllokimin e foltres. Këtë e shprehë qartë sot një prej figurave të rëndësishme të LSI-së, Luan Rama, pasi kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi i kërkoi të merrte fjalën për çështjet e rendit të ditës. "Në kushtet kur ky parlament funksionon në anomalitet të plotë, unë refuzoj ta marr fjalën. Jemi për të demonstruar që parlamentarizmi në këtë vend është institucion. Çdo sjellje apo qëndrim tjetër që cenon parlamentarizmin, nuk mund



të vazhdojmë më tej. Jemi përballë vendimit historik që do të mbajë Këshilli Europian në 28 qershor dhe ky degradim i parlamentarizmit është një arsye më shumë që Shqipëria nuk e meriton t'i çelen negociatat", tha Luan Rama. Ai lajmëroi se tërhiqet nga diskutimi për shkak të mungesës së normalitetit në seancë. "Unë theksoj që, e kam këtë vërejtje për ju, zoti Kryetar i Kuvendit, që ky institucion është pushtuar nga formalizmi. Kuvendi nuk bën analizë të punës së institucioneve. Ata vijjnë lexojnë dhe ikin. Kjo dëshmon se parlamentarizmi si institucion është kthyer në shembëlltëri mediokriteti. Unë jam gatë të flas, por në kushtet kur foltorja është e zënë, këtu mungon etika, e kam të pamundur të bëjë sfidë tani për të marrë fjalën me zorr Zbatoni Rregulloren dhe krijoni mundësinë që të vazhdojë diskutimi parlamentar, siç na ka hije ne", -tha z.Rama.

historike nga Shqipëria. -A e pe apo s'e pe, të paktën nuk iku si ti me rroba grash, po me helikopter! U largua me helikopter, jo si ti me rroga grash! Jepja fjalën!"

"Parlamenti ka rregulla, shtëpia ka tregulla, ulu poshtë dhe fol kur të vijë koha. Nuk ka hapje mikrofonit, nuk shkel rregulloren, rregullat i kemi vendosur bashkërisht do i zbatojmë bashkërisht, të bëj thirrje për herë të fundit të uletsh. Sa të mbarojnë tre drejtuesit e in-

PËRPLASJA

Pas debateve të shumta dhe pas qëndrimit dy orë të kreut të PD në foltore, kryetari i grupit parlamentar të PS, Balla kërkoi që të hidhen në votim pikat e rendit të ditës. Kjo është kundërshtuar nga opozita, e cila në shenjë protesta përplasi duart mbi tavolinë.



Seanca e djeshme parlamentare

PD e LSI, letër të përbashkët: Opozitës iu hoq e drejta e fjalës

Situata e krijuar në seancën e djeshme plenare detyroi krerët e grupeve parlamentar të PD dhe LSI, që përmes një letre të përbashkët të shprehin shqetësimin për ndërprerjen e diskutimeve të opozitës në parlament. Në letërën që mban nënshkrimet e Edmond Spaho dhe Petrit Vasili, theksohet se heqja e të drejtës së fjalës së opozitës është një akt i pa precedentë, që shënon një rekord antikushitetues në veprimtarinë e Kuvendit. Sipas tyre, "Votimi për t'i mohuar të drejtën e fjalës opozitës dhe pa lejuar diskutimin e deputetëve bën nul seancën e sotme plenare dhe të gjitha vendimet e marra". Deputetët Spaho dhe Vasili shprehën se "Dhunimi brutal i të drejtës së opozitës për të folur nga Kryetari i Kuvendit dhe mazhoranca dëmon në mënyrë të parikuqeshme bashkëjetesën midis mazhorancës dhe opozitës në parlament".

Parlamentar të PS Balla kërkoi që të hidhen në votim pikat e rendit të ditës. Kjo është kundërshtuar nga opozita, e cila në shenjë protesta përplasi duart mbi tavolinë. Në kushtet kur diskutimet ishin të pamundura, mazhoranca kaloi në votimin e projektligjeve. Ndryshe nga gjithë deputetët e opozitës, Nasip Naço dhe Edmond Haxhinasto të LSI-së morën pjesë në votim edhe pse vullneti i tyre ishte kundër nismave ligjore të mazhorancës.



Kamp refugjatësh? Rama: S'na ka kërkuar kush të marrim 600 mijë sirianë

Basha: Gjermania ka vendosur, jo negociata për Shqipërinë

"Kryeministri po blen Europën me sirianët"

Valentina Madani

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha njoftoi dje në Kuvend se Gjermania ka deklaruar votën e saj kundër hapjes së negociatave me Shqipërinë. Për më shumë se një orë Lulzim Basha blloko i foltoren e Kuvendit duke mos lejuar asnjë diskutim veç çështjes së negociatave për Shqipërinë, për të cilën tha se ka ardhur edhe vendimi i Gjermanisë. Ai akuzoi kryeministrin Edi Rama se e ka fshehur dy net më parë lajmin e keq për shqiptarët. Basha tregoi disa nga arsyet e forta që ka vendosur Bundestagu gjerman që të pengojnë sipas tij hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE. "Edi Rama është informuar për fatin e negociatave dhe të integritetit të Shqipërisë. Ai ka ardhur të bëjë të paditurin, akoma me keq të fshehtë të vërtetën, apo ta manipulojë atë. Mbrëmë, (parrmbrëmë) vetëm 24 orë pas samitit franko-gjerman dhe takimit Merkel-Macron, kristian-demokratët dhe kristian-socialët gjermanë, aleatët e partisë jonë si motër dhe social-demokratët gjermanë aleatët dhe partisë simotër e PS kanë rakorduar qëndrimin e tyre sa i përket hapjes së negociatave me Shqipërinë. Edi Rama ka gënjyer. Nuk i ka bërë detyrat, se Shqipëria nuk i ka plotësuar kushtet për hapjen e negociatave. Në këtë rezolutë që do të bëhet zyrtare javën e ardhshme të martën, për herë të parë Shqipërisë nuk i vendosen thjesht kushte, por edhe një proces kontrolli që demonstroi pabesueshmërinë totale ndaj çdo raportimi që është bërë deri më sot nga Edi Rama apo nga harka institucionale e blerë prej tij", deklaroi z.Basha. Më tej kreu, i PD-së, akuzoi kryeministrin Rama se me anë të refugjatëve po kërkon të blejë heshtjen e Europës për situatën e drogës dhe korrupsionit në vend. "Ky tani ofron pazar të marrë 600 mijë sirianë, 500 mijë shqiptarë i çoi refugjatë, por është gati të marrë 600 mijë sirianë. Kjo është fantazma që sillet tani nëpër Europë", theksoi z.Basha.

REPLIKA

Kryeministri Edi Rama nuk foli dje në parlament për çështjen e refugjatëve edhe pse është një nga çështjet më të diskutuara, por ka gjetur një vend tjetër për të bërë sqarime. Ndërkohë që flitet se



ngritja e kampeve për refugjatët e lindjes në Shqipëri është një kusht nga Europa, Rama mohon kategorikisht që kjo gjë i është kërkuar nga ndonjë vend. Ndërsa një komentues e ka ngacmuar për refugjatët në "Facebook", Rama i është përgjigjur me shprehjen se i vjen keq për 100 të mençurit që hidhen në lumë të gjejnë gurin e hedhur

nga një budalla. Komentuesi shkruan: "Rrofsh, zoti kryeministër, shumë vepër e madhe jam krenar për ty edhe Shqipërinë, por mua një gjë nuk më pëlqen, njerëzit që e shkelin!! Do ishte më mirë ta shijonin 600 mijë sirianët, pakistanezët, iranianët etj. Atje do ishte kryevepër fare. Dikur kemi qenë edhe ne në vendin e tyre dhe vazhdojmë, por nuk

tha njeri JE SUIS ALBANAISE, as nuk na ndërtaun nga një kamp as nuk na falen gjë, por çdo gjë e fituam! Budalla je ti që kujton se njerëzit janë budallenj... mbrapa". Kurse kryeministri Rama u përgjigj: "Domethënë, ti që je i mençuri në këtë mes mendon se vërtetë ekziston mundësia që Shqipërisë t'ia kërkojë kush në botë të marrë 600 mijë sirianë këtu eee?! Epo mësoje se nuk na ka kërkuar kush të marrim as 600 mijë, as 60 mijë dhe as 6 mijë! Domethënë ti që di ku e ka bishtin dardha mendon vërtetë që të ketë në këtë botë qeveri e shtete, që të imagjinojnë ngritjen e një kampi për 600 mijë refugjatë në një vend të vetëm eee?! Epo mësoje se nuk ekziston asnjë shtet apo qeveri në botë që të ketë këtë nivel budallallëku!

AVOKATI I POPULLIT

Institucioni i Avokatit të Popullit ngre alarmin se vendi ynë nuk ka kapacitetet e duhura të për plotësuar nevojat e tyre. "Numri i personave që kthehen është gjithnjë e më i madh dhe do të na duhen kapacitete më të mëdha dhe më shumë sa i përket rolit të mekanizmit në lidhje me mbrojtjen nga trajtimi çnjerëzor", - deklaroi Erinda Ballanca.

SHKURTE

Spaho: Vendi s'ka përmbushur asnjë kusht për negociatat

Kreu i Grupit Parlamentar të PD-së, Edmond Spaho e quajti të paprecedentë atë çfarë ndodhi dje në parlament. Spaho tha në News24, se nuk kishte ndodhur kurrë në historinë e parlamentarizmit që të pritët fjala e opozitës. I pyetur se në çfarë pozicioni e vendos opozitën kjo situatë, Spaho tha atë të përplasjes. "E vendos në pozicion të përplasjes frontale me maxhorancën. Opozita ka vetëm fjalën në Kuvend dhe nëse i heqim dhe fjalën, atëherë këtu s'ka më parlamentarizëm. Opozita kthehet në fasadë të maxhorancës dhe për rrjedhojë vendi s'ka më demokraci, kthehet në diktaturë", - u shpreh Spaho. Sipas tij Shqipëria nuk ka përmbushur asnjë kusht për hapjen e negociatave dhe kjo është arsyeja që PD dhe opozita në çdo seancë ka kërkuar të flitet për këtë çështje. "Qëndrimi ynë është i qartë. Nuk jemi në një situatë normale, por anormale dhe të diskutosh për çështje të rendit të ditës, që presin, ndërkohë që emergjencat është integrimi euro-pian, nuk është e udhës", - u shpreh Spaho.

Kreu i FRPD me këshilltarin e CDU: Kushtet për Shqipërinë

Kreu i FRPD, Belind Këlliçi takoi në Bundestagun Gjerman, Hans-Joachim Falenskin, Këshilltarin për Marrëdhëniet me Jashtë të CDU/CSU me të cilin foli për kriteret që duhet të përmbushë Shqipëria për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE. Këlliçi shprehet se lufta kundër korrupsionit dhe drogës, si dhe emigrimi masiv i shqiptarëve gjatë viteve të fundit, kanë qenë ndër çështjet e diskutuara. "Takimet vijuan në Bundestagun Gjerman, me Hans-Joachim Falenskin, Këshilltarin për Marrëdhëniet me Jashtë të CDU/CSU. Kriteret që Shqipëria duhet të përmbushë për hapjen e negociatave dhe integrimin në BE, lufta kundër korrupsionit dhe drogës, emigrimi masiv i Shqiptarëve e në veçanti i të rinjve si dhe organizimi i Akademisë Politike të FRPD ishin temat kryesore të diskutimit", - tha kreu i FRPD, Belind Këlliçi.

Njoftim i shoqërisë Vodafone Albania Sh.A.

Të nderuar Klientë,

Vodafone Albania Sh.A. ju njofton se duke filluar nga data **24 Korrik 2018**, do të ofrojë katër plane tarifore të reja me vlefshmëri mujore për pajtimtarët me paspagesë si më poshtë:

Paketa 1	Paketa 2	Paketa 3	Paketa 4
5 GB Internet pa limit	10 GB Internet pa limit	15 GB Internet pa limit	20 GB Internet pa limit
2500 & 250 Minuta & SMS kombëtare	4000 & 400 Minuta & SMS kombëtare	Pa limit Minuta & SMS kombëtare	Pa limit Minuta & SMS kombëtare
Pa limit SMS drejt Vodafone	Pa limit SMS drejt Vodafone	Pa limit SMS drejt Vodafone	Pa limit SMS drejt Vodafone
100 Minuta Ndërkombëtare	200 Minuta Ndërkombëtare	300&50 Minuta Ndërkombëtare	400&100 Minuta Ndërkombëtare
2,500 Lekë/muaj me TVSH	4,800 Lekë/muaj me TVSH	8,400 Lekë/muaj me TVSH	11,800 Lekë/muaj me TVSH

Planet tarifore Mini Red, Red, Red Advantage, Red Premium, Red Elite nuk do të ofrohen më në treg.

Pajtimtarët me paspagesë të cilët kanë një kontratë pajtimi të vlefshme nuk do të preken nga ky ndryshim. Klientet e rinj dhe ata të cilët do të rinovojnë kontratën e tyre në dyqanet Vodafone do të mund të përzgjedhin vetëm një nga planet tarifore të përmendura më sipër.

Për më shumë informacion, vizitoni dyqanet Vodafone ose kontaktoni Shërbimin e Klientit 149.



"I riu kishte shfaqur probleme shëndetësore në komisariat"

Vdekja e Enea Ftoj në parburgim, prokuroria akuzon tre efektive policie: S'i dhanë ndihmë

KORÇË - Një ditë pas daljes së ekspertizës mjekoligjore, mësohet se Prokuroria e Korçës ka ngritur akuzë për tre efektive të komisariatit të këtij qyteti për mosdhënie ndihme ndaj 27-vjeçarit Enea Ftoj, që ndërroi jetë në ambientet e parburgimit. Burime nga organi i akuzës dje bënë me dije për "GSH" se pas konkluzioneve të ekspertizës mjekoligjore që saktësoi se i riu nuk është dhunuar në ambientet e policisë, hetimet po

REAGIMI I FAMILJARËVE

"Im bir është dhunuar barbarisht. Isha vetë në morg dhe i pashë shenjat në trup dhe fytyrë. Jemi të bindur që është dhunuar. Kërkojmë zhvarrosjen e trupit dhe të bëhet përsëri ekspertizë. Nëse nuk do zbardhet e vërteta, do të bëjmë vetëgjyqësi", deklaroi dje babai i 27-vjeçarit, i cili një muaj më parë u gjet i vdekur në parburgim.

vijonë. "Fakti që i riu nuk ka vdekur nga dhuna, nuk do të thotë që policia nuk ka përgjegjësi penale për vdekjen e tij. Ka prova që efektive të policisë nuk i kanë dhënë ndihmë Enea Ftoj,

edhe pse ai kishte shfaqur probleme shëndetësore gjatë dy ditëve të qëndrimit në ambientet e komisariatit", thanë burimet nga Prokuroria e Korçës. Ndër-kaq, po të njëjtat burime pohuan se



27-vjeçari Enea Ftoj

policia ka shkelur rregulloren e trajtimit të të shqëruarve dhe nuk ka kryer kontrollin periodik në qelinë e 27-vjeçarit. Të mërkurën, drejtorja e Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA,) Anila Trimi teksa bazohej tek ek-

spertiza mjekoligjore, deklaroi se 27-vjeçari Enea Ftoj ndërroi jetë për shkak natyralë dhe jo nga dhuna. Ky pretendim u hodh poshtë nga familja e viktimës, e cila kërkoi zhvarrosjen e Enea Ftoit dhe kryerjen sërish të ekspertizës.

Vëllai i autorit: Ishte një moment, Hajriu është i urtë. Unë e dorëzova në polici

Plagosja e dyfishtë në Durrës, babai: Do e fal djalin, edhe pse bëri gabim

75-vjeçari Neziri: Nga fëmija çfarë nuk pret. Nusja e tij, Elvisa u përpoq të na mbronte



Fisnik Neziri duke folur për "GSH"



75-vjeçari Destan Neziri, duke folur për "GSH"

Nuk është e vërtetë që ne nuk e duam nusen e djalit", u shpreh i moshuari. Mësohet se bashkëshortët Neziri me origjinë nga Dibra kanë punuar mësues në arsimin e ciklit të ulët deri sa kanë dalë në pension.

VËLLAI I AUTORIT

Në lidhje me krimin në familje ka reaguar dhe vëllai i autorit të ngjarjes, Fisnik Neziri, i cili pohoi se nuk e kupton motivin që e shtyu vëllain e tij të vogël drejt këtij akti. Sipas tij, ngjarja

mund të ketë ardhur si pasojë e një depresioni, pasi siç tregon ai, marrëdhëniet mes të riut dhe prindërve nuk ishin konfliktuale. "Një moment, gjendje depresioni. Nuk mund t'i japim shpjegim. Nuk e kuptojmë

dot se si ka ndodhur. Çuni është shumë i urtë. Babi e mami nuk kanë pasur ndonjëherë probleme me Hajriun. Unë isha në punë në Tiranë, kur erdhën të dy, vëllai dhe nusja e tij. I pyeta çfarë kishin, por asnjëri nuk tha asnjë fjalë. Vëllai kishte një të çarë në pëllëmbë të dorës dhe i thashë eja të të çoj në spital. E çova te Spitali i Traumës për mjekim. Kuptova se diçka kishte ndodhur në shtëpi me prindërit, ndaj i thashë një polici që ishte aty: "Lajmëro që të vijë t'i marrë se këta diçka e kanë bërë". Gjithashtu Fisniku, djali i madh i familjes Neziri tregoi se Hajriu ka punuar për afri 5 vjet së bashku me të në njëntë firmë private dhe se më pas Hajriu e la punën dhe është i papunë.

SHKURTE

Aksidentohen futbollistët Alban Hoxha dhe Lorenc Trashi

TIRANË - Një lajm i keq për Partizanin, pasi dy prej futbollistëve të kësaj skuadre kanë mbetur të lënduar në një aksident. Bëhet fjalë për portierin Alban Hoxha dhe mesfushorin Lorenc Trashi, të cilët janë aksidentuar mbrëmjen e së martës në afërsi të Kërrabës. Në aksident u përfshinë dy makina, një "Audi A6" dhe një "BMW X5", ku në mjetin e fundit udhëtonin dy futbollistët. Burime për "Gazeta Shqiptare" dje bënë me dije se fatmirësisht Hoxha dhe Trashi nuk kanë pësuar lëndime të mëdha, ndërkohe mjeti i tyre u dëmtua shumë. Po ashtu, thuhet se pasi kanë marrë mjekim në spital, dy futbollistët janë larguar për në banesat e tyre. Ndërkaq, burime nga policia pohuan se shkak i aksidentit është bërë një manovër e gabuar e "Audit", ku drejtuesi i saj ka shkelur rregullat e qarkullimit. Për pasojë, ai është gjobitur dhe do të dalë në komision.

Tentoi të grabiste taksistin me armë, prangoset 17-vjeçari

ELBASAN - Policia e Elbasanit ka parandaluar një grabitje me armë, që ndodhi dy ditë më parë në fshatin Kërcyk. Burime zyrtare bënë me dije se 17-vjeçari me inicialet S.H., lindur në Gramsh dhe banues në Elbasan, i maskuar dhe nën kërcënimin e armës ka tentuar që të grabisë 51-vjeçarin G.M., banues në fshatin Kuqan, i cili ka qenë duke lëvizur me autometjin e tij taksitë markës "Benz Mercedes". Gjatë kontrollit të adoleshentit që u kap në flagrancë, iu gjetën në një çantë sportive një pushkë, 25 fishekë, një maskë dhe një palë doreza, të cilat ai i përdorte për të realizuar grabitjet.

DURRËS

Klodiana Haxhia

Fëmija të bën atë që nuk ta pret mendja. Ishim duke parë një ndeshje të Botërorit dhe në momentin që u bë gol, djali u nervozua keq dhe na goditi mua dhe gruan. Ngjarja ndodhi shumë shpejt. Por, pavarësisht kësaj, unë nuk e hedh poshtë tim bir se ai bëri një gabim. Unë jam prind e një prind për fëmijën e ka zemrën të madhe, ndaj do e fal atë". Kështu deklaroi dje nga spitali i Durrësit ku ndodhet i shtruar, 75-vjeçari Destan Neziri, i cili pasditën e së mërkurës u godit me thikë në fytyrë dhe në fytyrë nga djali i tij 25-vjeçar, Hajri Neziri. Çmendurisë së të riut nuk i shpëtoi edhe bashkëshortja e tij 64-vjeçare, Asie Neziri, e cila mori 6 goditje thike në bark. Një ditë pas krimit në familje, që ndodhi në zonën e ish-Kënetës në Durrës dhe që tronditi opinionin publik, mësohet se gjendja shëndetësore e dy të moshuarve ka ardhur duke u përmirësuar: 75-vjeçari është shtruar në repartin e kirurgjisë, ndërsa bashkëshortja e tij pritet të dalë nga reanimacioni. Ndërkaq, Destan Neziri tha për "GSH" se i biri e kreu aktin e rëndë në zemërim e sipër: **DËSHMIA E TË PLAGOSURIT**

Ndonëse u masakrua me thikë nga djali dhe për pak rrezikoi të humbte jetën së bashku me të shoqen, Destan Neziri u shpreh se do ta falë atë, pasi është fëmija i tij dhe jo i botës. "Kur të shërohemi së bashku me gruan do e shikojmë djalin. E përsëris, ai e bëri atë që bëri në zemërim e sipër", u shpreh 75-vjeçari i plagosur. Ndërkaq, ai sqaroi se nuk ka debatuar me Hajriun. Gjithçka ishte momentale. "Ishte nusja 20-vjeçare, Elvisa që na doli në krah dhe po përpiqej të ndalonte të fejuarin e saj që të mos na godiste me thikë.

DURRËS - Pronarët e motorëve të detit, skafeve, skive ujore e të lojërave të argëtimit për pushuesit janë hedhur dje në protestë. Ata akuzojnë Policinë Kufitare që me një akt të paprecedent kërkon të bllokoi të gjithë aktivitetin e këtyre mjeteve ujore që përdoren për lojëra dhe argëtim nga ana e pushuesve. Pjesëmarrësit në tubim thanë se kanë investuar miliona lekë, por



Patentë për pushuesit që marrin me qira mjetet ujore, pronarët e tyre në protestë

nuk i lejojnë të ushtrjnë aktivitetin e tyre, edhe pse janë të licencuar. Shkak është bërë futja e një pike të re në kontratën e këtyre subjekteve me Policinë Kufitare. Policia Kufitare e Durrësit këtë vit, ndryshe nga vitet e shkuara, kërkon që çdo pushues të

ketë leje drejtimi për të marrë me qira një mjet ujor, çka bllokoi automatikisht aktivitetin e këtyre subjekteve. "Turistët trajnohen para se të ngasin një motor uji. Nëse nuk shkon siç duhet, ne e komandojmë me pulm mjetin ujor nga bregu. Kemi ndërtuar vendbazime

të sigurta 450 metra larg nga bregu për të shmangur çdo aksident", u shprehën subjektet e mjeteve ujore. Mësohet se këto subjekte kanë kryer investime që shkojnë deri në 100 mijë euro për mjetet ujore për argëtimin e pushuesve. **kl.ha.**

Ish-truproja: Berisha pagoi 1 mln euro për eliminimin tim. Avokati: Kemi prova të reja, të pyeten 21 politikanë

Izet Haxhia fiton 'betejën', rihapet dosja 'Hajdari'

Gjykata pranon kërkesën e të dënuarit me 25 vite burg për rigjykim

TIRANË

Izet Haxhia, i dënuar me 25 vite burg si bashkëpunëtor në vrasjen e Azem Hajdarit ka fituar të drejtën për t'u rigjykuar. Gjykata e Tiranës ka pranuar dje kërkesën e ish-truprojës së ish-kryeministrit Berisha për rivendosjen në afat, çka mundëson rihapjen e dosjes "Hajdari", e konsideruar si dosja e shekullit. Vendimi i gjykatësit Besnik Hoxha u prit me duartrokitje në sallë, ku ishte i pranishëm vetë Haxhia dhe disa të afërm të tij. Gjatë seancës së djeshme, Izet Haxhia hodhi sërish akuza të forta në drejtim të ish-kryeministrit Sali Berisha, për të cilin tha se kish-te paguar klanet e drogës me 1 milion euro, me qëllim eliminimin e tij. "Berisha pagoi 1 milion euro që të më hiqte qafe në Turqi, por nuk ia doli. Dosja 'Hajdari' është treguesi i qartë i futjes së duarve të kimit në drejtësi nga klanet e malësorëve të Tropojës dhe të Skraparit. Të dënohem, por së pari të dëgjojmë", tha Izet Haxhia. Ndërkohë, në seancën e kaluar Izet Haxhia tha se nuk është njoftuar në atë kohë për dënimin e tij dhe i është rrezikuar jeta, ndërsa prokuroria publikoi shkresat dhe u shpreh se Izeti është njoftuar. Ai kërkoi sërish ballafaqim me Sali Berishën. "Unë kam ardhur këtu që të dëgjojmë. Nga vitet '90-të deri '98-ën jam dëshmitar i shumë ngjarjeve që i 'dëgjin' Sali Berishës. Dua një ballafaqim me Sali Berishën", - tha Izet Haxhia në seancën e kaluar.

Pas vendimit të djeshëm të Gjykatës së Tiranës, reagoi avokati i tij, Bashkim Nikolla. Ai e cilësoi ditë të mirë për drejtësinë vendimin e gjykatës në fjalë për rigjykimin e klientit të tij. Sipas avokatit, Izet Haxhia është dënuar me prova të sajura dhe se ai është i pafajshëm. Në një intervistë për "News 24", Nikolla sqaroi me detaje se klienti



Izet Haxhia në sallën e gjyqit




Azem Hajdari

i tij që pretendon pafajsinë do t'i drejtohet tashmë Gjykatës së Apelit. Avokati u shpreh se klienti i tij ka prova, të cilat do t'i bëjë prezente në momentin e duhur. Ndërsa, foli për të paktën 21 politikanë shqiptarë për të cilët do të kërkohet dëshmia në lidhje me një nga vrasjet më të bujshme në Shqipëri. "Të merret vesh se kush e vrau Azem Hajdarin, pse të

mos merret vesh kur klienti im është i pafajshëm", - deklaroi avokati.

Çfarë ndodhi në seancën e sotme?

Bashkim Nikolla: Me këtë vendim që mori gjykata e Shkallës së Parë flet shumë, është një ditë e mirë për Shqipërinë, për drejtësinë që kriminelët e vërtetë të dënohen. Është hapur rruga për të regjistruar nga ana jonë, për të proceduar



Avokati Bashkim Nikolla

REAGIMI I SHKËLZEN BERISHËS

Pas lajmit se Gjykata e Tiranës ka pranuar kërkesën e Izet Haxhisë për të rihapur dosjen "Hajdari", e konsideruar si dosja e shekullit, ka reaguar djali i ish-kryeministrit Sali Berisha, Shkëlzeni, i cili në një postim në rrjetet sociale, shkruan: "Pas lirimit të shumë kriminelëve të tjerë, Rama përgatit lirin e vrasësit të Azemit".

E DASHURA E IZET HAXHISË

E dashura e Izet Haxhisë ka reaguar pas vendimit të Gjykatës së Tiranës, e cila i ka hapur rrugën rigjyimit të ish-truprojës së Sali Berishës, i dënuar në mungesë me 25 vite burg si i përfshirë në vrasjen e Azem Hajdarit. Përmasë një postimi në "Facebook", e dashura e Haxhisë thotë se drejtësia dha shenjat e para që nuk është kthyer në kufomë dhe se kjo është vetëm etapa e parë e një lufte të gjatë.

DËNIMI I ISH-TROPROJËS

Izet Haxhia është dënuar me 25 vite burg nga gjykatat shqiptare për vrasjen e Azem Hajdarit në 12 shtator të vitit 1998, akuzë të cilën e mohon. Ai u arrestua në vitin 2006 në Turqi, por drejtësia turke nuk ishte shprehur për ekstradimin e tij, ndonëse pala shqiptare kishte bërë kërkesa të vazhdueshme në kohën kur në pushtet ishte Sali Berisha. Për 12 vjet me radhë gjykata turke kishte urdhëruar që ai të mos largohej jashtë vendit, ndërsa në shkurt të këtij viti u mor vendimi që ai të ekstradohet.

më tej me ankimin. Do rendisin provat dhe do themi pse jemi të pafajshëm, pra do provojmë që na takon pafajësia.

Keni prova të reja?

Bashkim Nikolla: Sigurisht që ka prova. Nuk është momenti për t'i bërë të njohura. Ne do sqarojmë pozicionet tona dhe mbështetjen në prova reale.

Çështja tani shkon në Apel?

Bashkim Nikolla: Pat-

jetër na është hapur rruga të ridëgjojmë e gjykojmë në një dosje skandaloze. Vetëm dje kemi pasur mundësi të prekim dosjen prej 702 faqesh. Janë mbi 21 politikanë me në krye të parin e vendit, që organi i akuzës u ka bërë thirrje të paraqiten dhe nuk kanë shkuar të dëshmojnë. Kanë pasur një sell partiake dhe nuk e kanë përfillur drejtësinë. Do kërkojmë gjithë këta politikanë të dëshmojnë. Të

gjithë e kërkojnë kush është vrasësi i Azem Hajdarit? Të gjithë ta marrin vesh kush është.

I qëndroni akuzës së bërë nga Izet Haxhia se është paguar 1 milion euro për ta eliminuar fizikisht?

Bashkim Nikolla: Po, do ta vërtetojmë porositësin, se Izet Haxhia ka pasur rrezik permanent për jetën. Të bëhet drejtësi, pa bota të përmbysët. Unë kam shumë besim tek drejtësia.

TIRANË - Ka kaluar në "sitën" e vetingut gjyqtari i Apelit, Ilir Toska, i cili është konfirmuar në detyrë. Vendimi është dhënë dje nga Kolegji i Pavarur i Kualifikimit. Ndërkohë, Toska është kandidat edhe për KLGJ. Dy ditë më parë, Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar vlerësoi se e gjente të përpërshtatshëm në detyrën



Gjyqtari i Apelit, Ilir Toska

Vetingu, gjyqtari i Apelit, Ilir Toska del "i pastër". KPK: Konfirmohet në detyrë

e gjyqtarit, Ilir Toskën. Vlerësimi i këtij institucioni është bërë publik në seancën gjyqësore në Kolegjin e Pavarur të Kualifikimit, i cili nga ana e tij e ka vlerësuar si të pabazuar këtë

konkluzion të DSIK-së. Toska sipas raportit të lexuar në KPK, ka një pasuri të paluajtshme, një apartament 83 metra katrore me vlerë 80 mijë euro në Rrugën "Ali Demi" në Tiranë. Gjyq-

tari ka kërkuar rikonfirmimin në detyrë. "E konsideroj procesin e rregullt ligjor, të paanshëm, jam dakord me të, për këtë arsyeje kërkoi rikonfirmim", është shprehur në seancë Toska.

Udhëzimi/ Miratohen datat e provimeve kombëtare

Matura Shtetërore, dalin rezultatet e Gjuhë-Letërsisë, 1363 nxënës nuk kalojnë testin

Qendra e Shërbimeve Arsimore ka shpallur rezultatet e provimit të detyrueshëm të Maturës Shtetërore 2018-të, atij të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë. Ministria e Arsimit, në njoftimin e saj për mediat bëri me dije se 1363 maturantë u vlerësuan me notën 4, çka do të thotë se 3.8% ndër 35609 nxënës që iu nënshtruan testit, nuk mundën ta kalonin atë. Ndërkohë vetëm 0.6% e maturantëve u vlerësuan maksimalisht me notën 10, pra 221 nxënës në total. Pritet që në ditët në

vijim maturantët të njihen edhe me rezultatet e provimit të detyruar të Matematikës, si dhe atij të lëndëve me zgjedhje të zhvilluar dy ditë më parë.

PROVIMET KOMBËTARE

Ditën e djeshme, Këshilli i Ministrave ka miratuar udhëzimin e Ministrisë së Arsimit mbi datat e provimeve kombëtare të arsimit bazë në sesionin e dytë. Kështu testi i gjuhës së huaj për nxënësit e vitit shkollor 2017-2018 do të zhvillohet në 24 gusht të këtij viti, ai i gjuhës shqipe në 28 gusht e 3

ditë më pas, pra në 31 gusht do të mbahet edhe provimi i fundit, ai i matematikës. Në udhëzim më tej theksohet se nxënësit e pakicave kombëtare do të zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë, sesioni i dytë, në lëndën Gjuhë amtare. "Provimi kombëtar i arsimit bazë, sesioni i dytë, në lëndën Gjuhë amtare, do të zhvillohet më 22 gusht 2018. Për provimet kombëtare të arsimit bazë 2018, sesioni i dytë, të ndiqen procedurat e përcaktuara në urdhrin nr. 88, datë 23.2.2018. "Për miratimin e rregullores për

"Procedurat e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2017-2018", nënvizohet në udhëzim. Sakaq, provimet kombëtare të arsimit bazë 2018, sesioni i dytë, do të fillojnë në orën 10:00 dhe do të zgjasin 2 orë e 30 minuta. Hartimi i testeve do të kryhet sipas rregullores për procesin e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë 2018. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën Gjuhë amtare, sesioni i dytë, përgatitet nga DAR



Foto ilustruese

Gjirokastrë. Ndërkohë për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, teza për provimin në lëndën Gjuhë amtare, sesioni i dytë, përgatitet nga DAR

tetit nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR Korçë. Vo.Du

Ambasada: Kushtet dhe dokumentacioni për të fituar vizën, ku duhet të keni kujdes

Voltiza Duro

Të gjithë qytetarët që dëshirojnë të jetojnë e punojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë mundësi të përfitojnë nga vizat për çiftet. Ditën e djeshme, ambasada amerikane u ka bërë thirrje të gjithë personave që të kenë kujdes, pasi kategoritë e vizave mes çifteve të martuara dhe atyre të fejuar janë të ndryshme. "Ja këshilla ime: Kategoritë e vizës për çiftet e martuara është e ndryshme nga kategoritë e vizës për çiftet e fejuara", - theksojnë ekspertët. Kështu, në varësi të statusit që ka ka bashkëshorti, (qytetar amerikan, apo banor i përhershëm i ligjshëm - me 'Green Card'), ndryshojnë edhe procedurat. Ndryshimi ndërmjet tyre është koha e pritjes. Nëse bashkëshorti është qytetar amerikan, të interesuarit për bashkim janë në kategorinë IR1 ose CR1. Ndërkohë pasi dorëzohet peticioni I-130 tek USCIS, duhen rreth 5-8 muaj për miratim nga USCIS, pastaj dosja i kalon NVC. Rreth një muaj më pas, NVC kontakton qytetarin me dokumentacionin që duhet të dërgojë. Pasi individi i ka dërguar të gjitha dokumentet, NVC do të caktojë një datë takimi për intervistë në Seksionin Konsullor në Tiranë. "Sa më shpejt e sa më të saktë i dërgoni dokumentacionin e kërkuar NVC-së që në herën e parë, aq më shpejt ju caktohet data e intervistës nga NVC-ja", nënvizon ambasada amerikane në Tiranë.

VIZAT PËR TË FEJUARIT

Të gjithë ata persona që janë fejuar me një qytetar/e amerikan tashmë kanë mundësinë të përfitojnë vizë joemigruese të tipit K-1, e cila i jep mundësinë të shkojë në Shtetet e Bashkuara. Nëpërmjet kësaj vize, shtetasi i huaj që është fejuar me një amerikan, pas zhven-

Amerika hap dyert për të fejuarit, procedura e aplikimit "Ja ndryshimi i kategorive të vizave për të martuarit"

NDRYSHIMET

Kategoritë e vizës për çiftet e martuara është e ndryshme nga kategoritë e vizës për çiftet e fejuara", - theksojnë ekspertët. Kështu, në varësi se çfarë statusi ka bashkëshorti, ndryshojnë edhe procedurat. Ndryshimi ndërmjet tyre është koha e pritjes.



Ambasada amerikane

dosjes në SHBA, duhet që të marrohet brenda 90 ditëve pas mbërritjes e pas kësaj duhet të rregullojë statusin e tij në rezident të përhershëm të ligjshëm me zyrat Shërbimeve Amerikane të Shtetësisë dhe Emigracionit të Departamentit të Sigurisë Kombëtare. Për shkak se viza për të fejuarit i lejon mbajtësit të emigrojë dhe të marrohet me një qytetar amerikan menjëherë pas mbërritjes në Shtetet e Bashkuara, atij do t'i duhet të plotësojë disa nga kërkesat e vizës së emigrimit. Ndërkaq, fëmijët e ligjshëm të aplikantëve K-1 mund të marrin vizën K-2.

APLIKIMI

"Nëse i/e fejuari/ja juaj banon në Shqipëri, zyra jonë në ambasaden amerikane në Tiranë pasi merr peticionin

KUSHTET

- Nëse i/e fejuari/ja juaj banon në Shqipëri, zyra jonë në ambasaden amerikane në Tiranë pasi merr peticionin e përpunuar nga NVC, do të dërgojë udhëzime të detajuara mbi dokumentacionin e kërkuar dhe vizitën mjekësore të kërkuar.
- Kandidatit gjatë intervistës do t'i merren shenjat e gishtërinjve elektronikisht.
- Në disa aplikime vizash mund të jetë i nevojshëm procesi administrativ që kërkon kohë shtesë pas përfundimit të intervistës nga zyrat konsullor.
- Fëmijët e aplikantëve për vizë K-1 mund të aplikojnë për vizën e llojit K-2.
- Shtetasi amerikan duhet të kryejë aplikimin nga ana e tij me formularin "I-129F, petition për të fejuarin/en e huaj" në zyrat e emigracionit në SHBA.
- Zyrat konsullor do të informojë kandidatin nëse aplikimi i tij për vizë miratohet ose refuzohet.

e përpunuar nga NVC, do të dërgojë udhëzime të detajuara mbi dokumentacionin e kërkuar dhe vizitën mjekësore të kërkuar", - nënvizohet në faqen zyrtare të ambasadës amerikane. Ndërkohë, kandidatit gjatë intervistës

do t'i merren shenjat e gishtërinjve elektronikisht e madje në disa aplikime vizash mund të jetë i nevojshëm procesi administrativ, që kërkon kohë shtesë pas përfundimit të intervistës nga zyrat konsullor. Shumica e

proceseve administrative zgjidhen brenda 60 ditëve nga dita e intervistës, por gjithësi, kohëzgjatja varet nga rrethanat individuale? çdo rasti. Ndërkohë, fëmijët e aplikantëve për vizë K-1 mund të aplikojnë për vizën e llojit K-

"Nëse i/e fejuari/ja juaj banon në Shqipëri, zyra jonë në ambasaden amerikane në Tiranë pasi merr peticionin e përpunuar nga NVC, do të dërgojë udhëzime të detajuara mbi dokumentacionin e kërkuar dhe vizitën mjekësore të kërkuar", - nënvizohet në faqen zyrtare të ambasadës amerikane.

2, ndërsa një aplikim i veçantë duhet dorëzuar për çdo kandidat të vizës K dhe çdo aplikant i kësaj kategorije vize duhet të paguajë tarifën e kërkuar. Ndërkohë, edhe shtetasi amerikan duhet të kryejë aplikimin nga ana e tij me formularin "I-129F, petition për të fejuarin/en e huaj" në zyrat e emigracionit në SHBA. Në fund të intervistës për vizën emigruese, zyrat konsullor do të informojë kandidatin nëse aplikimi i tij për vizë miratohet ose refuzohet.

PENSIONET E PLEQERISE SIGURIMI VULLNETAR

“Si të merrni më shumë të ardhura, kufijtë e pagesës që mund të kryeni dhe tarifrat mujore”

ISSH, thirrje emigrantëve: Bëni sigurim për të përfituar pension

“Ja zbritjet që mund të fitoni nga parapagimet”

Voltiza Duro

Të gjithë emigrantët shqiptarë që jetojnë jashtë vendit mund të përfitojnë pension edhe në Shqipëri, edhe pse nuk i kanë plotësuar vitet e punës me kontribute. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ditën e djeshme u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve emigrantë që të sigurohen vullnetarisht për të marrë pagesën e pensionit të pleqërisë, invaliditetit, apo familjar. “Qytetarë emigrantë! Instituti i Sigurimeve Shoqërore ju ofron sigurimin shoqëror vullnetar, si një mundësi më shumë për të përfituar pension pleqërie, invaliditeti dhe familjar”, - thekson ISSH. Ndërkohë, kjo e fundit bën me dije për të gjithë të interesuarit se pensioni i plotë i pleqërisë përfitohet me 36 vite e 4 muaj punë të siguruar, ndërsa pensioni i pjesëm të përcaktuar minimalisht 15 vite pune me sigurime. Për të përfituar pension nga shteti shqiptar, emigrantët duhet të paguajnë një pagesë kontributi prej 5184 lekësh në muaj.



6%

3%

15%

ZBRITJE PARAPAGESË 1 VIT
“Nëse do të parapaguani në fillim të periudhave do të ketë zbritje 6% mbi shumën për një pagesë vjetore, 3% mbi shumën për një pagesë 6 mujore dhe 1.5% mbi shumën për një pagesë 3-mujore. Ju mund të siguroheni edhe për vitet e kaluara dhe mund të futeni në këtë skemë pa qenë të siguruar më parë. Kontribuoni për të kaluarën dhe të tashmen, t’ju sigurojmë të ardhmen!” - bën thirrje Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Por, nëpërmjet sigurimit vullnetar, mund të përfitojnë jo vetëm emigrantët shqiptarë, por të gjithë qytetarët që jetojnë në Shqipëri e dëshirojnë të kenë një masë pensioni më të lartë se ai që është paracaktuar më parë.

ZBRITJE PARAPAGESË 6 MUAJ
ISSH bën me dije se pensioni i plotë i pleqërisë përfitohet me 36 vite e 4 muaj punë të siguruar. Nëse do të parapaguani në fillim të periudhave, do të ketë zbritje 3% mbi shumën për një pagesë 6-mujore.

ZBRITJE PARAPAGESË 3 MUAJ
Pensionin i pjesëm të përcaktuar minimalisht 15 vite pune me sigurime. Nëse do të parapaguani në fillim të periudhave, do të ketë zbritje 1.5% mbi shumën për një pagesë 3-mujore.

Nëse do të parapaguani në fillim të periudhave do të ketë zbritje: 6% mbi shumën për një pagesë vjetore, 3% mbi shumën për një pagesë 6 mujore dhe 1.5% mbi shumën për një pagesë 3-mujore. Ju mund të siguroheni edhe për vitet e kaluara dhe mund të futeni në këtë skemë pa qenë të siguruar më parë. Kontribuoni për të kaluarën dhe të tashmen, t’ju sigurojmë të ardhmen!” - bën thirrje Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Por, nëpërmjet sigurimit vullnetar, mund të përfitojnë jo vetëm emigrantët shqiptarë, por të gjithë qytetarët që jetojnë në Shqipëri e dëshirojnë të kenë një masë pensioni më të lartë se ai që është paracaktuar më parë.

KUSHET E PËRFITIMIT
Në skemën e sigurimit vullnetar përfitohen shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe akoma nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sigurimit të detyruar; ata që për një kohë dhe shkaqe të caktuara nuk mund të sigurohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm si dhe personat që janë të siguruar në skemën e sigurimit të detyrueshëm dhe kërkojnë që nëpërmjet sigurimit vullnetar të rrisin të ardhurat e tyre. Sipas Institutit të Sigurimeve Shoqërore, edhe personat që nuk janë pjesë marrëse në skemën e të vetëpunësuarve në bujqësi,

ose në rastet kur individit i interesuar ka lënë shtetësinë shqiptare, mund të bëjë sigurim vullnetar vetëm për periudhën nga 1.1.1994 deri në datën që ka lënë shtetësinë shqiptare. “Personi që ka paguar kontribut për sigurim vullnetar, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në Ligjin nr. 7703, është përfitues, sipas rastit, i: pensionit të plotë të pleqërisë, pensionit të pjesëm të pleqërisë, pensionit të reduktuar të pleqërisë, pensionit të pleqërisë, pensionit të inval-

iditetit, pensionit të pjesëm të pleqërisë të invaliditetit”, - thekson ISSH. Ndërkaq në sigurimin vullnetar, sipas ligjit “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, bën pjesë edhe pensioni familjar. Kontributi vullnetar llogaritet në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale të caktuar nga Këshilli i Ministrave dhe paguhet nga personi i siguruar në shumën dhe afatin e përcaktuar në kontratën e sigurimit vullnetar. Nëpërmjet sigurimit vull-

etar mbulohe katër fusha të kësaj skeme që janë: sigurim vullnetar për vitin korrent, sigurim vullnetar për periudha të kaluara, sigurim vullnetar për më shumë të ardhura si dhe sigurim vullnetar për degët e tjera të sigurimit.

SIGURIM VULLNETAR PËR PERIUDHA TË KALUARA

Sigurimin vullnetar për periudhat e kaluara mund ta paguajnë të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe që nuk u ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar si dhe shtetasit shqiptarë meshkuj për periudhën e studimeve universitare, pasi periudha pasuniversitare është me pagesë. Ndërkohë, ky sigurim për periudhat e kaluara mund të bëhet edhe nga shtetasit shqiptarë që kanë periudha të pambuluara nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm dhe dëshirojnë t’i plotësojnë ato nëpërmjet sigurimit vullnetar si dhe personat që kanë lënë shtetësinë. Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar nga personi i interesuar për mbulimin e periudhave të kaluara përcaktohet nga koha kur bëhet pagesa. PAGESA AKTUALE PËR TË MBULUAR PERIUDHA TË KALUARA, bëhet vetëm në kuotën minimale dhe është 5184 lekë për një muaj sigurim vullnetar por në këto pagesa nuk

PERIUDHAT E KALUARA

- Sigurimin vullnetar për periudhat e kaluara mund ta paguajnë të gjithë shtetasit shqiptarë që:
 - Kanë mbushur moshën 18 vjeç.
 - Që nuk u ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar.
 - Shtetasit shqiptarë meshkuj për periudhën e studimeve universitare, pasi periudha pasuniversitare është me pagesë.
 - Ky sigurim për periudhat e kaluara mund të bëhet edhe nga shtetasit shqiptarë, që kanë periudha të pambuluara nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm dhe dëshirojnë t’i plotësojnë ato nëpërmjet sigurimit vullnetar si dhe personat që kanë lënë shtetësinë.
 - Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar nga personi i interesuar për mbulimin e periudhave të kaluara përcaktohet nga koha kur bëhet pagesa.
 - PAGESA AKTUALE PËR TË MBULUAR PERIUDHA TË KALUARA bëhet vetëm në kuotën minimale dhe është 5184 lekë për një muaj sigurim vullnetar, por në këto pagesa nuk aplikohen zbritjet.

SIGURIM VULLNETAR PËR VITIN KORRENT

Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën me dije se masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar për vitin korrent nga personi i interesuar është e barabartë me masën që paguhet për degën e pensioneve, sipas pagës minimale të miratuar në periudhën kur bëhet pagesa. “Kuota mujore e sigurimit vullnetar për vitin 2017 është 5184 lekë, që i korrespondon pagës minimale mujore: 24 000 lekë x 21.6%. Për pagesat paradhënie, aplikohen zbritjet në varësi të kohës kur kryhet pagesa. Kështu, nëse do të parapaguani për vitin në vijim në fillim të periudhave, do të ketë zbritje: 6% mbi shumën për një pagesë vjetore (me kusht që pagesat të realizohen brenda muajit janar); - 3% mbi shumën për një pagesë 6-mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 6-mujore, që do të mbulohe me sigurim vullnetar); - 1.5% mbi shumën për një pagesë 3 mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 3-mujore, që do të mbulohe me sigurim vullnetar)”, - theksohet në faqen zyrtare të ISSH-së. Gjithsesi, pagesat e vitit korrent mund të bëhen edhe me shumëfishin e kuotës minimale mujore, 5184 lekë, deri në kufi të

SIGURIM VULLNETAR PËR MË SHUMË TË ARDHURA

Sigurim vullnetar për më shumë të ardhura mund të paguajnë të gjithë personat ekonomikisht aktivë të vetëpunësuar, të punësuar dhe punëdhënësit, të cilët duhet të jenë të siguruar si të tillë në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Ky sigurim bëhet vetëm për vitin korrent në kufijtë e pagave minimale dhe maksimale, 24 000 dhe 105 850 lekë (qytetari ka të drejtë të zgjedhë një pagë brenda këtij kufiri). ISSH bën me dije se personat e vetëpunësuar sigurohen me pagë minimale mujore 24 000 lekë e mbi këtë pagë çdo person ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht deri në kufirin e pagës maksimale 105 850 lekë. Ndërkohë, punëmarrësit që sigurohen në bazë të kontratës të nënshkruar me punëdhënësin kanë të drejtë të sigurohen vullnetarisht për më shumë të ardhura mbi pagën që ata marrin deri në nivelin e pagës maksimale 105 850 lekë. Çdo punëdhënësi që sigurohet në nivelin e pagës maksimale ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht deri në kufirin e kësaj page, ndërsa çdo kontribuues vullnetar për vitin korrent ka të drejtë të sigurohet për më shumë të ardhura.

Qytetaret shqiptare do të kenë shërbime më cilësore pagesash për shkak se Banka e Shqipërisë po ndërmerr një projekt për dixhitalizimin e sistemit të pagesave. Duke prezantuar këtë nismë Guvernatori i BSH, Genti Sejko tha se, zhvillimi i sigurt dhe efikas i sistemeve të pagesave përbën një objektivi shumë të rëndësishëm, jo vetëm në mbështetje të zbatimit të politikës monetare dhe ruajtjes së stabilitetit financiar, por edhe si një mjet i rëndësishëm për një zhvillim ekonomik të formalizuar dhe të qëndrueshëm. Ai tha se synim parësor në këtë drejtim është përdorimi i gjerë i instrumenteve të pagesave në përditshmërinë e qytetarëve. Kjo mënyrë e re zhvillimi kërkon identifikimin dhe plotësimin e nevojave edhe të komponen-

Sejko: Interneti mjet i rëndësishëm për një zhvillim ekonomik

BSH, nismë për dixhitalizimin e sistemit të pagesave

tit më të vogël përbërës të ekonomisë - individit dhe biznesit, tha ai. Në kushtet e tregut shqiptar, i cili karakterizohet nga një përfshirje dhe edukim financiar i ulët, si dhe shërbime të ofruara me kosto relativisht të larta, synimi ynë do të jetë nxitja e sistemit bankar në ofrimin për qytetarët të shërbimeve lehtësisht të aksesueshme e me kosto efektive, duke mbështetur kështu objektivin e një përfshirjeje më të gjerë financiare. Nevoja për ndërhyrje në këtë drejtim bëhet më e rëndësishme dhe sfiduese,

sidomos teksa përjetojmë zhvillime teknologjike të shpejta e gjithëpërfshirëse. Në kushtet kur shumica e aspekteve të jetës së përditshme po dixhitalizohen dhe automatizohen, modernizimi i sistemeve të pagesave bëhet edhe më i rëndësishëm. Bazuar në studimet dhe analizat e kryera nga Banka e Shqipërisë më mbështetjen e Bankës Botërore, evidentohet qartazi se promovimi i dixhitalizimit dhe inovacionit në tregun e pagesave ndikon ndjeshëm në uljen e kostove të mbartura nga

këto instrumente, duke krijuar shërbime lehtësisht të aksesueshme dhe të përbalueshme nga të gjithë. Në Shqipëri, ky zhvillim është ndjeshëm më i vonuar se në vendet e tjera, me të cilat ne synojmë të përafrohemi në kuadër të integritimit në Bashkimin Europian, ndaj promovimi i tij merr akoma më shumë vlerë e rëndësi jo vetëm në kuadër të këtij integritimi, por edhe më gjerë, në tregjet ndërkombëtare, tha Guvernatori. Modernizimi i këtyre sistemeve përmes dixhitalizimit dhe inovacionit



Guvernatori i BSH, Genti Sejko

do të synohet nëpërmjet një zhvillimi të mirëregulluar dhe me objektivat qartësisht të përcaktuar në strategjinë afatmesme, e cila do të prezantohet sot në këtë konferencë. Si një nismë konkrete në këtë drejtim mund të përmendim transpozimin e direktivës së Bashkimit Eu-

ropian, e cila konsiderohet si një nga legjislacionet më avangardë të fushës. Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim dhe me ekspertët të Bankës Botërore dhe Bankës së Italisë kanë hartuar një projektligj për këtë qëllim, i cili si shpejti do të jetë objekt konsultimesh publike.

Problemet e sigurimeve, AMF raporton në Kuvendin e Shqipërisë

Ornela Manjani

AMF: Siguruesit të paguajnë menjëherë 7 milionë euro

Pagesat e prapambetura nga viti 2001 e në vazhdim

Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i AMF-së, Ervin Koçi raportoi në Kuvendin e Shqipërisë dhe bëri të ditur se tregu i sigurimeve ngelet i pazhvilluar dhe problematik në drejtim të standardeve të qeverisjes dhe menaxhimit. Çështja më e vështirë ngelet trajtimi dhe shlyerja e dëmeve nga Byroja Shqiptare e Sigurimeve, që është përgjegjëse për dëmet e shkaktuara nga mjetet e pasiguruara. Me gjithë presionin në rritje, Byroja ende nuk ka shlyer plotësisht dëmet e prapambetura dhe nuk ka caktuar një shoqëri ndërkombëtare për auditimin e veprimtarisë së saj, siç kishte urdhëruar AMF. Veç probleme të tjera, AMF nuk po arrin as të miratojë një drejtor të Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, i cili të përmblushë kriteret ligjore. Pas shumë përpjekjesh, në muajin maj, asambleja e anëtarëve të Byrosë paraqiti një kandidat për miratim në AMF, siç parashikohet në ligj. Por, kandidatura e drejtorit të komanduar, Kevin Lleshi, u refuzua në fillim të qershorit nga Bordi i AMF-së, për shkak se ai ka qenë subjekt i masave administrative dhe në mënyrë të përsëritur nuk ka zbatuar vendime të marra nga Autoriteti Mbikëqyrës. Problematika e mbartur nga viti 2001, me pagesat e prapambetura me Fondin e Kompensimit duket se po shkojnë drejt zgjidhjes. Vendimi i marrë mbi Fondin e Kompensimit për vitin 2018 nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në mbledhjen e datës 28 dhjetor 2017, vjen në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, çka i jep zgjidhje një problematike të mbartur nga viti 2001. Tashmë këto dëme i përkasin aksidenteve të shkaktuara nga makina të pasiguruara ose të paidentifikuara.

VLERËSIMET
Sipas vlerësimeve masa e Fondit të Kompensimit për



Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i AMF-së, Ervin Koçi

detyrimet e mbartura dhe që do të lindin për vitin 2018 vlerësohet rreth 1.8 miliardë lekë, e ndarë: 1.25 miliardë lekë për ngjarjet nga viti 2001 deri 31.12.2013 ku përfshihen detyrime të paguara, që

janë në proces trajtimi apo proces gjyqësor pa vendim të formës së prerë; 418 milionë lekë për ngjarjet nga viti 2014 deri në 31.12.2017 ku përfshihen detyrime të paguara, që janë në proces trajtimi apo

proces gjyqësor pa vendim të formës së prerë, dhe jo më pak se 150 milionë lekë për ngjarjet që mund të ndodhin gjatë vitit 2018. Bordi i AMF-së ka urdhëruar Byronë Shqiptare të Sigurimit që të nd-

jekë procedurën e shlyerjes së menjëhershme të detyrimeve të paguara të praktikave të dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit, për të cilat ka përfunduar procesi i trajtimit (përmbarimor, me vendim gjykate të formës së prerë dhe të miratuar, por të papaguara) në vlerën totale 923 354 758 lekë për ngjarjet e sigurimit nga data 01.01.2001 deri në 31.12.2017.

BORXHI I RI
Njëkohësisht, për të mos krijuar borxh të ri, Bordi i AMF-së vendosi krijimin e Fondit të Kompensimit për vitin 2018, minimalisht në masën 895 203 094 lekë, i ndarë: 745 203 094 lekë për shlyerjen e detyrimeve për ngjarjet nga 1 janar 2001 deri në 31 dhjetor 2017 (që janë në

proces trajtimi apo procese gjyqësore, pa vendim të formës së prerë) dhe jo më pak se 150 milionë lekë për ngjarjet që mund të ndodhin gjatë vitit 2018. Vendimi bën të mundur që çdo qytetar që gjatë vitit 2018 fiton një vendim të formës së prerë nga gjykatat ose i miratohet nga shoqëritë e sigurimit, do të paguhet brenda vitit 2018. Autoriteti, ashtu si në shumë vendime të marra gjatë vitit 2017, do të vazhdojë të fokusohet tek mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe e konsideron shlyerjen e detyrimeve të Fondit të Kompensimit si një ndër prioritetet kryesore të veprimtarisë së tij gjatë vitit 2018, edhe pse këto detyrime kanë filluar të mbarten prej vitit 2001.

PAGESAT
1.25 miliardë lekë për ngjarjet nga viti 2001 deri 31.12.2013 ku përfshihen detyrime të paguara, që janë në proces trajtimi apo proces gjyqësor pa vendim të formës së prerë; 418 milionë lekë për ngjarjet nga viti 2014 deri në 31.12.2017 ku përfshihen detyrime të paguara, që janë në proces trajtimi apo proces gjyqësor pa vendim të formës së prerë, dhe jo më pak se 150 milionë lekë për ngjarjet që mund të ndodhin gjatë vitit 2018.

Miratohet edhe leja për Rrugën e Arbrit, 5 HEC-e dhe dy plane vendore

Vendimi i KKT, kullë e re me 21 kate në Tiranë



Planin e Detajuar të Zonës së Rëndësishme Kombëtare në Zonën e Karavastasë, Bashkia e Divjakës. Një tjetër leje është dhënë për shtesë katesh dhe Rikonstrukcion fasade për objektin: "Sky Tower", me vendndodhje në rrugën "Ibrahim Rugova", Bashkia Tiranë", me subjekt zhvillues shoqërinë

"Lani" sh.p.k. Në listën e vendimeve janë edhe disa leje për ndërtimin e një seri hidrocentralesh në disa zona të vendit duke nisur nga Gramshi në Mirditë, Mat dhe Korçë. Në total janë të paktën pesë leje për burime të reja gjeneruese. Kompania që ka me koncesion rrugën e Kombit Alba-

nian Highway Concession ka kërkuar leje ndërtimi Zyra 4 Kat me 2 Kat nëntokë në Mjulle Bathore, Bashkia Tiranë", me subjekt zhvillues Shefqet Kastrati dhe Pëllumb Saillari, ndërkohë që kompania Gjoka që ka marrë të drejtën e ndërtimit të Rrugës së Arbrit ka kërkuar lejen e ndërtimit për zbatimin e projektit. Ceremonia e fillimit të punimeve për këtë rrugë u zhvillua në fillim të kësaj jave ku morën pjesë kryeministri Edi Rama dhe ministri për Infrastrukturën dhe Energjinë, Damian Gjiknuri.

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, përfituesit në të gjithë vendin

Ornela Manjani

Miratohet fondi për kompensimin e pronarëve që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Fondi arrin në 732 milionë për sipërfaqe prej 43 965 m². Në total janë rreth 1200 pronarë që do të marrin paratë për tokën. Përfituesit janë në Tiranë, Kamzë Vorë, Elbasan, Durrës, Fshatra Turistikë dhe Shkodër. Vendimi është marrë në mbledhjen e djeshme të Këshillit të Ministrave dhe në pikën 2 të tij thuhet se "masa e kompensimit është 43 965,31 m² dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 731 847 186,22 lekë". Qeveria udhëzoi zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të

Kompensimi i pronave, lista me 1200 pronarët që marrin paratë

Qeveria miraton fondin 732 milionë lekë

paluajtshme, përkatësisht në Tiranë, Elbasan, Durrës dhe Shkodër, të kryejnë ndryshimet përkatëse për këto pasuri në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Ndërkohë që ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Legalizimit, Ur-

banizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Agjencia e Trajtitimit të Pronës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi. Për të

përfituar kompensimin për tokën e zënë nga ndërtimet pa leje duhet të paraqesin në ATP-së kërkesë për kompensim në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale (ALU-IZNI). Pronari plotëson një

kërkesa për kompensimin në vlerë sipas formatit Tip që vihet në dispozicion nga ATP-ja. I interesuari duhet të paraqesë dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve,

në përpunje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt notarial të sille certifikatë familjare e personit, për të cilin është lëshuar kjo dëshmi trashëgimie. Një tjetër dokument është vërtetimi i lëshuar nga banka e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare ku do të transferohet vlera financiare e përfutur. ATP kërkon fotokopjen e dokumentit të identifikimit, dhe certifikatën familjare të kërkuarit dhe mandatpagesën, që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit.

LISTA ME 1200 PRONARËT QË KOMPENSOHEN

Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)		
10	11	12	15	16		
NADIRE		PELLUMB	302.80	4,242		
EMINE		FULAJ				
MERJEM		DURDA				
LIRIJE		DAKA				
GJERAGJIN		SKENDERAG				
IRENA		PELLUMB				
GENTI		PELLUMB				
IRIS		PELLUMB				
Bislim Muhamet Allaraj					12.50	3,283
BESMIK		DERVISH			109.70	29,106
DERVISH		DERVISH				
FIQIRETE		DERVISH				
IBRAHIM		DERVISH				
NADIRE		DERVISH				
NJAZI		DERVISH				
SELFIE		DERVISH				
METIJE		DERVISH	7.90	29,106		
AFERDITA		LUNKU	14.50	29,106		
IHSAN		BANKA				
LUMNIJE		PAJA				
MYNEVER		ZAMBAKU				
RIZVAN		BANKA				
SARA		TARTARI				
VILDAN		BANKA				
VJOLLCA		LLAGAM				
XHEVDET		FERHATI			48.30	29,106
FATMIR	ABDULLA	FERHATI			128.60	29,106
VJOLLCA		FERHATI	124.10	29,106		
FATMIR QAMIL KOSTA			42.90	66,969		
ANDUELA		CIMA	221.50	32,878		
BAFTISHA		SHTISHI				
BESIM		SAUKU				
ERVIN		CIMA				
FATBARDHA		QINAMI				
FERID		SAUKU				
FIQIRETE		BEKTESH				
GEZIM		SAUKU				
HAXHI		SAUKU				
LIRIE		AGA				
NAZIE		STERMASI				
NIMETE		DEMNERI				
PETRIT		SAUKU				
QEFSER		SHILLOVA				
SADUE		DERVISHI				
SKENDE		SAUKU				
TIRE		SALLAKU				
AGIM	SELIM	KOKONOZI			227.00	31,270
BAHRI	SELIM	KOKONOZI				
BARDH	SELIM	KOKONOZI				
HYSËN	SELIM	KOKONOZI				
MAHMUJ	SELIM	KOKONOZI				
PRANVE	SELIM	KOKONOZI				
SAM	SELIM	KOKONOZI				
ZEQINE	SHABA	KOKONOZI				
ADRIAN		NAXHAKU				
ANILA		MANCJA				
ANOLA		NAXHAKU				
ARTAN		DERVISHI				

Kompensimi i Pronarëve				
Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)
10	11	12	15	16
TIRE		SALLAK	770.00	32,878
Bakushe		SAUKU		
ANDUELA		CIMA		
BAFTISHA		SHTISHI		
BAKUSHE		SAUKU		
ERVIN		CIMA		
FATBARDHA		QINAMI		
FERID		SAUKU		
FIQIRETE		BEKTESH		
GEZIM		SAUKU		
HAXHI		SAUKU	756.40	32,878
LIRIE		AGA		
NAZIE		STERMASI		
NIMETE		DEMNERI		
PETRIT		SAUKU		
QEFSER		SHILLOVA		
SADUE		DERVISHAJ		
SKENDE		SAUKU		
Besim		Sauku		
TIRE		SALLAKU		
ANDUEL		CIMA	221.50	32,878
BAFTIS		SHTISHI		
BESIM		SAUKU		
ERVIN		CIMA		
FATBARD		QINAMI		
FERID		SAUKU		
FIQIRET		BEKTESHI		
GEZIM		SAUKU		
HAXHI		SAUKU		
LIRIE		AGA		
NAZIE		STERMASI		
NIMETE		DEMNERI		
PETRIT		SAUKU		
QEFSER		SHILLOVA		
SADUE		DERVISHI		
SKENDE		SAUKU		
TIRE		SALLAKU		

Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)		
10	11	12	15	16		
EDUART		HOTI	420.00	32,878		
FATMIR		KOKONOZI				
FIQIRETE		KOKONOZI(HO)				
GENC		MANCJA				
HALLIL		KOKONOZI				
HANKË		KOKONOZI(MA)				
JAKUP		NAXHAKU				
NAIME		KOKONOZI(SHU)				
ARBEN DAUT TABAKU					61.80	32,878
BUJAR	DAUT	TABAKU				
HATLUE	DAUT	TABAKU				
MIRANDA	DAUT	TABAKU				
SKENDER	DAUT	TABAKU				
SULLTAN	ISUF	TABAKU				
BESNIKE	SADIK	MEMA				
EDMOND	HASAN	MEMA				
FIQIRETE	SADIK	MEMA				
JALLDIS	SADIK	MEMA				
LEJLAH		MEMA	27.90	31,270		
SADIK	HASAN	MEMA				
KLUJTIM		MAÇI			227.00	31,270
MUSA		MAÇI				
EMINA		MAÇI				
GIORGIA		DAL'OLMO				
ROBERTO		MAÇI				
ALESSAN		MAÇI				
GJERAGJIN		SULA				
REZARGJ		COCOLI				
BESNIK		PETRELA				
ILIRJAN		TUGU				
FATJON		TUGU				
IRIS		TUGU				
ZAMIR		NDROQI				
PETRIT		NDROQI				
MAJLINDA		NDROQI				
SERXHO		PETRELA				
VASILIKA		PETRELA				
DOLOREZ		RRAPOLLARI				
LINDITA		DERMISHI				
SADIK	HAKIK	SHPATA	26.00	33,755		
EDUARD		SHPATA	155.00	33,755		
LEJLA		SHPATA				
PELLUMB		SHPATA				
RAJMOND		SHPATA				
EDUARD		SHPATA				
LEJLA		SHPATA				
PELLUMB		SHPATA				

12 - EKONOMI

FLORENC	TODI	MUSTAKA	26.00	33,755
GEZIM		PESHKOPIA	15.00	33,755
MIHALLA		DEMIRI		
FLUTURA	HAKIK	MARKU	18.00	33,755
SADIK		SHPATA	211.00	33,755
XHEVRIE		ZELI		
SKENDER		ZELI		
ARBEN		ZELI		
ALBAN		ZELI		
ASTRIT		ZELI		
GAZMEND		ZELI		
LAERTA		ZELI		
MIMOZA		ZELI	6.70	33,755
SHPETIM		ZELI		
SANIE		SINANI		
ZELI		CELMETA		
SHPRES		KOLA		
MUSTAF		ZELI		
VALBO		DODA		
MYZEJE		TARTARI		
AIDA		FRASHERI(BES)		
ARDIAN		TOPTANI		
BEHUE		ALDA((TOPTAN		
FADIL		TOPTANI		
MELEQ		FRASHERI		
MYNYR		TOPTANI		
NADIA		FRASHERI		
NIRVAN		(FRASHERI)LEK		
XHEMILE		TOPTANI	622.00	33,755

RIZVAN		BANKA		
VILDON		BANKA		
ISLAM		BANKA		
MYNEV		ZAMBAKU		
AFERDIT		LUNIKU		
MAHMU		LUNIKU		
LUMNIJE		PAJA		
VJOLLC		LLAGAMI	270.10	30,783

FA-MA KONSTRUKSION			9.90	30,783
--------------------	--	--	------	--------

FA-MA KONSTRUKSION			8.20	30,783
--------------------	--	--	------	--------

AGRON	HASAN	BOGDANI		
ATLUE	HASAN	YLLI		
BILAL	HASAN	BOGDANI		
DIANA	KADRIU	BIBA		
ENIDA		BOGDANI	329.00	30,783
FATMIR		BOGDANI		
RAMAZA		BOGDANI		
RESHAT	HASAN	BOGDANI		
SAIMIR		BIBA		

QEFSERE	ISMAIL	ZHEGU		
FATMIRE	SEFER	VATHI		
PETRIT	ISMAIL	SHPATI		
DURIM	OSMAN	KOKOLI		
HYSEN	OSMAN	KOKOLI		
MUHAMET	ISMAIL	SHPATI		
KUUTIM	ISMAIL	SHPATI		
VJOLLCA	ISMAIL	DUSHKU		
SKENDER		SHPATI		
ALMA		MYFTIU		
BRIKENA	OSMAN	MURATI		
ARBEN	BESIM	SINA		
ZHULIETA	BESIM	HARASANI	272.90	31,219
ADEM	OSMAN	DEMNERI		
AFERDITA	XHA FER	DEMNERI		
AGIM	OSMAN	DEMNERI		
ARIANA	RAMAZ	DEMNERI		
BUJAR	OSMAN	DEMNERI		
ENVER	XHA FER	DEMNERI		
ESHREF	SALI	DEMNERI		
FITNETE	SALI	DEMNERI		
HAKI	XHA FER	DEMNERI		
KUUTIM	SALI	DEMNERI		
NADIRE	SALI	DEMNERI	200.00	31,219
NAZMIE	SALI	DEMNERI		
NIMETE		DEMNERI		
NIRVAN	RAMAZ	DEMNERI		
QEMAL	SALI	DEMNERI		
RUBIE		DEMNERI		
SANIE	XHA FER	DEMNERI		
SHPRESA	OSMAN	DEMNERI		

RAKIP	LIMAN	VORPSI		
IKBALE	SALI	MNERI		
LEJLA	LIMAN	VORPSI		
LULZIM	MYSLY	JUMA		
MIMOZA	ADEM	YLLI		
SANUE	MYSLY	JUMA		
ABDULLA	SEFER	SHEQERI		
LINDITA	ABDULL	SHEQERI		
SUZANA	SADIK	MYFTIU		
MYZEJEN		ZYRBO		
NERMIN	SALI	VORPSI		
SEFER	ABDULL	SHEQERI		
VALBON	ADEM	YLLI		
SHEFKI	MYSLY	JUMA		
XHAVIT	LIMAN	VORPSI		
YLBER	MYSLY	JUMA		
NAZMI	MYSLY	JUMA		
ARJANA	MASAR	VORPSI(MACI)		
BARDHYL	MASAR	VORPSI	924.00	22,985

RAKIP	LIMAN	VORPSI		
IKBALE	SALI	MNERI		
LEJLA	LIMAN	VORPSI		
LULZIM	MYSLY	JUMA		
MIMOZA	ADEM	YLLI		
SANUE	MYSLY	JUMA		
ABDULLA	SEFER	SHEQERI		
LINDITA	ABDULL	SHEQERI		
SUZANA	SADIK	MYFTIU		
MYZEJEN		ZYRBO		
NERMIN	SALI	VORPSI		
SEFER	ABDULL	SHEQERI		
VALBON	ADEM	YLLI		
SHEFKI	MYSLY	JUMA		
XHAVIT	LIMAN	VORPSI		
YLBER	MYSLY	JUMA		
NAZMI	MYSLY	JUMA		
ARJANA	MASAR	VORPSI(MACI)		
BARDHYL	MASAR	VORPSI	836.70	22,985

Shoq. " Anonime Industriale " (36.10	34,068
---------------------------------	-------	--------

ALFRED		FY SHKU		
EDMOND		FY SHKU		
FATBARD		FY SHKU		
FIQIRI		FY SHKU		
LULJETA		FY SHKU		
MUHAMET		FY SHKU		
REXHEP		FY SHKU		
XHEVDET		FY SHKU	306.90	30,158

FIQIRI	DALIP	KARAJ (F)	300.10	3,283
--------	-------	-----------	--------	-------

SELIM	HAXHI	CEKA	5.80	31,270
VJOLLCA	SURE	CEKA		
KRYEGJYSHATA BOTERORE E			401.00	31,270
MITAT	ZENEL	HIDAJ		
SADIK	ZENEL	HIDAJ		
ZAMIRA	SABRI	MARKU		
BUJAR	SABRI	DAJA		
FATMIRA	SABRI	MULLALIU		
ILIRJANA		HUTA(HIDAJ)		
MINIR	SABRI	DAJA		
YLLKA	SABRI	DAJA		
FATIME	MUJARRE	ASLLANI	188.20	31,270

AIDA		TUGU		
ANASTAS		GORENCA		
ISLAM		TUGU		
ARDIAN		MACI		
MIRAND		FUGU		
NJAZI		TUGU	201.80	23,703
JASHAR	MUSTAFA	XHAMETA		
SHABAN	MUSAFI	XHAMETA	70.30	23,703
KRYEGJYSHATA BOTERORE			351.00	31,270
KRYEGJYSHATA BOTERORE			88.50	31,270

AGIM	HYSEN	MUMAJESI		
AISHE	HYSEN	MUMAJESI		
ALTN	ABDYL	HYKA		
ARBEN	XHEMAL	MUMAJESI		
ASTRIM	MUJARRE	KAIMI		
BAJRAM	REXHEP	TAFAJ		
BESNIK	XHEMAL	MUMAJESI		
DHURATA	SHEFQET	DEHEMI		
DJANA	BAJRAM	TAFAJ		
ENVER	XHEMAL	MUMAJESI		
FATBARD	XHEMAL	MUMAJESI		
FATMIR	HYSEN	MUMAJESI		
FLUTURA	SHEFQET	KRJETANI		
GUGASH	SHEFQET	HOXHA		
HATIXHE	MURAT	KAIMI		
HAVA	HAXHI	DUXHA	152.50	31,270
ISUF	XHEMAL	MUMAJESI		
JETMIRA	MUJARRE	HAKA		
LUAN	XHEMAL	MUMAJESI		
MAJLIN	XHEMAL	MUMAJESI		
MEREM	SHAQIR	HYKA		
NIMETE	OSMAN	CELA		
PELLUM	XHEMAL	MUMAJESI		
PETRIT	XHEMAL	MUMAJESI		
REXHEP	MUJARRE	KAIMI		
SABRUE	OSMAN	PCARI		
SHOQO	SHEFQET	DINO		
SILVAN	MUJARRE	SHIMA		
SULEJIM	ABDYL	HYKA		
VERA	SHEFQET	VAKIARI		
YLLI	BAJRAM	TAFAJ		
BUJAR		DAJA		
DYLBER		KELLCI		
FATMIR		MULLALIU		
MINIR		DAJA		
YLLK		DAJA		
ZAMIRA		MARKU	163.80	31,270

ARBEN	FRENG	FROKU	249.00	23,703
-------	-------	-------	--------	--------

KIMETE	LAZAN	FEJZA		
NERTILA	HAKI	FEJZA		
ANDA	HAKI	FEJZA		
KUUTIME	HAKI	FEJZA	135.30	4,242

JOANA	KOSTAND	HAXHI	280.30	3,413
-------	---------	-------	--------	-------

EDUARD		SHPATA		
LEJLA		SHPATA		
PELLUM		SHPATA		
RAJMO		SHPATA	17.30	33,755
JANI	VENIAMIN	DURRI		
GJINOVEF	TAHOR	DURRI	22.10	33,755
KADRI	SHERIF	HYSENLIKAJ	56.20	33,755

FATIME		QOSJA		
ALTN		QOSJA		
GENTA		PRODANI(QOSJ		
ISMAIL		QOSJA		
NAIRE		HARASANI		
REZARTA		MENERI		
XHILDA		TUFINA		
FATBARD		QOSJA	231.50	3,413
AGIM	SELIM	KELMENDI		
XHEMAL	SELIM	KELMENDI		
LIRI	SELIM	KELMENDI(XHU	300.10	3,413
FLAMUR	VATH	YMERI	86.40	
SHERIF	MAHMUT	HOXHA	73.40	
TAHIR	KADRI	BALLA		
NAIME	KADRI	BALLA	20.20	3,413

MALIQ	ISUF	LULI	187.60	479
MALIQ	ISUF	LULI	100.80	479
YLLI	ISUF	LULI	103.10	
HAXHI	ABDYL	KASHARI	40.00	479
SULEJMA	SABRI	IDERSHAJ	12.00	
HAXHI	ABDYL	KASHARI	254.00	479

PELLUMB	SEFER	MAKSUTAJ	138.30	
PETRIT	SEFER	MAKSUTAJ		
SHKELQIM	AVDI	KOCAJ	92.70	
DALLEND	ISLAM	LAMI	301.50	507

GEZIM	HASAN	TOTA	4.60	
KUJTIM	HALIL	MACI		
MUSA	HALIL	MACI		
EMINA	TOMOR	MACI		
GIORGI		DAL'OLMO(MA		
ROBERT	EQEREM	MACI		
ALESSAN	EQEREM	MACI		
GJERAQ		SULA(PETRELA		
REZARGJ		COCOLI		
BESNIK	XHA FER	PETRELA		
LIRJAN		TUGU		
FATJON		TUGU		
IRIS		TUGU		
ZAMIR		NDROQI		
PETRIT		NDROQI		
MAJLIN		NDROQI		
SERXHI	LULZIM	PETRELA		
VASILIK	SOTIR	PETRELA		
DOLORE		RRAPOLLARI		
LINDITA		DERMISHI(GRUC	3.40	31,270

MALIQ		ABAZI		
HAXHIR		ABAZI		
FATIME		DERJA		
XHAVRI		RIZA		
OSMAN		ABAZI		
HATIXH		BALLA		
KUMERI		BALLA		
BARDH		ABAZI		
KAJE		MUJAJEZI		
SHERIFE		HOXHA		
VELI		ABAZI		
RAZIE		RAUFI	73.90	33,755
MUHAR		ABAZI		
REFIK		ABAZI		
HARIZ		ABAZI		
SHEQER		ABAZI		
XHEMILE		ABAZI		
MUSA		ABAZI		
BUJAR		KOLA	9.40	
LUTFI		KOLA		
MYFTA		DOCI	21.80	

MALIQ		ABAZI		
HAXHIR		ABAZI		
FATIME		DERJA		
XHAVRI		RIZA		
OSMAN		ABAZI		
HATIXH		BALLA		
KUMERI		BALLA		
BARDH		ABAZI		
KAJE		MUJAJEZI		
SHERIFE		HOXHA		
VELI		ABAZI		
RAZIE		RAUFI		
MUHAR		ABAZI		
REFIK		ABAZI		
HARIZ		ABAZI		
SHEQER		ABAZI		
XHEMILE		ABAZI		
MUSA		ABAZI	64.80	
BUJAR		KOLA	13.90	
LUTFI		KOLA		
FLAMUR	ISMAIL	LOKA	69.00	33,755

ALBERT		LULJA		
BEDRIE		LULJA		
BEXHET		LULJA		
FERDINAN		LULJA		33,755
HAMIDE		LULJA		
HUME		LULJA		
KUME		LULJA		
NAZIF		LULJA		
HALIT		LULJA		
SHKELQIM		LULJA	227.00	
MYSLYM		BALLA		
FADIL		BALLA		
HAMIT		BALLA		
MEREME		BALLA		
DRITA		BALLA		
SANUE		BALLA		
BAKUSHE		BALLA		
BUKURUE		BALLA		
MUSTAFA		BALLA		

AVDULLA		BALLA		
KASEM		BALLA		
YLLKA		BALLA		
ADNAND		BALLA		
ELDA		KURTI		
MEDIHA		BALLA		
FATBARD		BALLA		
MYZEJEN		BALLA		
LULZIM		BALLA	147.00	33,755

XHEMAL		BROCA		
ANXHELA		GURRA		
ARBEN	SPIRO	GURRA		
MIMOZA	SPIRO	CVILO		
DASHAMI	SHYQY	HAJDARI		
SHAZIME	SHYQY	HAJDARI		
HAJRI	HAMDI	DOMI		
EDMOND	HAMDI	DOMI		
LUMTURI	HAMDI	RECI		
AISHE	LUKE	BROCA		
FATBARD	HYSEN	THACI		
ELMIRA	HYSEN	BROCA		
ANA	HYSEN	BROCA		
KETI	SPIRO	GURRA		
SOTIR	SPIRO	GURRA		
TATJANA	SHYQY	CELA	430.30	32,878
RAZUE	SHYQY	ALIAJ		
VJOLLCA	HAMDI	KOKOMIRI		
IRMA		BROCA(BALLA		
NADILE	HYSEN	TOPALLI		
ANDUELA		CIMA		

BAFTISHA		SHTISHI		
BESIM		SAUKU		
ERVIN		CIMA		
FATBARD		QINAMI		
FERID		SAUKU		
FIQIRETE		BEKTESHI		
GEZIM		SAUKU		
HAXHI		SAUKU		
LIRIE		AGA		
NAZIE		STERMASI		
NIMETE		DEMNERI		
PETRIT		SAUKU		
QEFSERE		SHILLOVA		
SADUE		DERVISHI		
SKENDER		SAUKU		
TIRE		SALLAKU		
BAKUSHE		SAUKU	160.20	
ANDUELA		CIMA		

BAFTISHA		SHTISHI		
BAKUSHE		SAUKU		
ERVIN		CIMA		
FATBARD		QINAMI		
FERID		SAUKU		
FIQIRETE		BEKTESHI		
GEZIM		SAUKU		
HAXHI		SAUKU		
LIRIE		AGA		
NAZIE		STERMASI		
NIMETE		DEMNERI		
PETRIT		SAUKU		
QEFSERE		SHILLOVA		
SADUE		DERVISHAJ		
SKENDER		SAUKU		
BESIM		SAUKU		
TIRE		SAUKU	209.00	

QAMILE	HAXHI	BEGA		
SHPRESA	BEDRI	KONI(BEGA)		
ET HEM	BEDRI	BEGA		
MERITA	BEDRI	MERJA(BEG		
MYSLIM	BEDRI	BEGA		
MEJTE	BEDRI	BRARI(BEG		
NAIME	SHABA	BEGA		
BASHKIM	HAMIT	BEGA		
SADETE	HAMIT	TUJANI(BEG		
MAKBULE	HAMIT	XHAJA(BEG		
LIR	HAMIT	BEGA	216.80	32,878

LULZIM		KIKA		
HALIL		KIKA		
AFERDITA		VORPSI		
VJOLLCA		VORPSI		
LIRI		KIKA		
FLUTURA		VERZIVOLLI		
NAZIRE		KIKA		

SADETE		KIKA		
SOKOL		KIKA		
ARJETA		KIKA		
HATUSHE		KIKA		
BARDHYL		KIKA		
AVENIR		KIKA		
VERA		KIKA		
ALDA		KIKA		
KLEJDA		KIKA	58.95	30783

ALMA	SHEFQET	BOGDANI		
BEDRUE		MOLLA		
ISMAIL	SHEFQET	BOGDANI		
KUJTIM	SHEFQET	BOGDANI		
NAILE		BOGDANI	4.95	30783

DIANA	ALEKSANDER	HOXHA		
ROBERT	ALEKSANDER	DAKO		
VIKTORIA	ALEKSANDER	RULI	83.90	22985

AGIM		JASA		
ANI		JASA		
ANILA		SHUTERIQI		
ARTAN		BANCI		
BESNIK		JASA		
ERMIRA		JASA		
FELIKS		JASA		
FISNIK		JASA		
FITNET		JASA		
FRIDA		JASA		
GENC		JASA		
GEZIM		JASA		
MIMOZA		BERXOLLI		
REZART		JASA		
YLLI		JASA		
ZANA		BANCI	29.30	66969

HALIL		KIKA		
LULZIM		KIKA		
AFERDITA		VORPSI		
VJOLLCA		VORPSI		
LIRI		KIKA		
FLUTURA		VERZIVOLLI		
NAZIRE		KIKA		
SADETE		KIKA		
SOKOL		KIKA		
ARJETA		PLESHTI		
HATUSHE		KIKA		
BARDHYL		KIKA		
VERA		KIKA		
ALDA		KIKA		
KLEJDA		KIKA		
AVENIR		KIKA	28.85	30783

BAJRAM	XHA FER	PREZA		
MEZIKO	RESUL	KALAJA	19.52	66969

BULENT		XHUGLINI		
DHURATA		XHUGLINI		
FITNETE		XHUGLINI		
MARLIND		XHUGLINI		

Dialogu Kosovë-Serbi, Thaçi: Është koha për marrëveshje historike

Vuçiç: Pro kompromisit, por s'i nënshtrohem presionit

Opozita refuzon ftesën e presidentit kosovar

Me rastin e vazhdimet të dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit në Bruksel, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç ka deklaruar se Serbia është e gatshme të bisedojë për kompromise, por jo edhe të pranojë çfarëdo presioni, shkruajnë mediat serbe. Gjatë një konference për gazetarë, Vuçiç ka deklaruar se ka kontaktuar me zyrtarë të Brukselit të cilëve u ka thënë se: "nëse janë të vërteta qëndrimet e shqiptarëve, atëherë nuk ka nevojë të shkoj në Bruksel të humb kohë", duke pretenduar se kine ata e kanë lutur që të shkojë në Bruksel, transmeton Telegrafi. "Nëse mendoni se mund të me detyroni t'i dëgjoj dhe shërbej Haradinajt, Hotit dhe Hoxhajt, mos më thirrni"- ka shtuar Vuçiç. Ai ka thënë para gazetarëve se nuk i frikësohet presionit të perëndimit. "Kenë gjetur personin e gabuar për t'i bërë presion. Nëse jeni të gatshëm të bisedojmë për kompromise, jemi të gatshëm", ka thënë për fund presidenti serb. Ndërkohë që presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, tha të mërkurën se Kosova duhet të rregullojë mosmarrëveshjet me Serbinë dhe të arrijë në një marrëveshje që do të mundësojë normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes të Kosovës e Serbisë. Ai i bëri këto komente një ditë pasi mori ftesën për një raund të ri bisedimesh në Bruksel me presidentin e Serbisë, Aleksander Vuçiç në Bruksel. "Jam i bindur se ka ardhur koha që pas bisedimeve që në një mënyrë apo tjetër po zgjas-



Aleksander Vuçiç



Hashim Thaçi

ALEKSANDËR VUÇIÇ

"Jam i bindur se ka ardhur koha që pas bisedimeve, të cilat në një mënyrë apo tjetër po zgjasin tash e njëzet vite, që të nënshkruhet një marrëveshje historike në mes të Kosovës dhe Serbisë, me të cilën do të përfundonte një epokë tragjike mbi një shekullorë në raportet në mes dy shteteve dhe popujve tanë", - ka thënë Vuçiç.

in tash e njëzet vite, që të nënshkruhet një marrëveshje historike në mes të Kosovës dhe Serbisë, me të cilën do të përfundonte një epokë tragjike mbi një shekullorë në raportet në mes dy shteteve dhe popujve tanë", tha ai. "Arritja e marrëveshjes gjithëpërfshirëse me Serbinë është e domosdoshme për synimin tonë që të bëhemi shtet anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për të përshpejtuar procesin e integritimit të Kosovës në

Bashkim European dhe në paktin NATO. Për të siguruar vendin e merituar të Kosovës në arenën ndërkombëtare", tha ai. Presidenti Thaçi tha se edhe në këtë fazë Kosova do të ketë mbështetjen e fortë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat sipas tij, janë thellësisht të interesuara për arritjen e marrëveshjes përfundimtare. "Nevoja për arritjen e kësaj marrëveshjeje i tejkalon mandatet tona politike të përkohshme. Shkon edhe

përtej raporteve aktuale midis partive qeverisëse apo opozitare, duke i bërë të papërfillshme lidhjet afatshkurtra në mes të politikaneve dhe partive në Kosovë. Kosova në asnjë rrethanë nuk mund të refuzojë dialogun apo negociatat", tha ai. Takimi i së dielës në mes të dy presidentëve shihet si një përplekje për t'i hapur rrugë arritjes së një marrëveshjeje detyruese ligjore për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre. Ndërsa opozita e Kosovës i ka thënë 'jo' ftesës së presidentit Hashim Thaçi për t'u përfshirë në fazën finale të dialogut me Serbinë, e cila do të nisë këtë të diel. Kreut të shtetit, madje, nuk i njihet as e drejta për ta përfaqësuar Kosovën në këtë proces, shkruante

HASHIM THAÇI

"Arritja e marrëveshjes gjithëpërfshirëse me Serbinë është e domosdoshme për synimin tonë që të bëhemi shtet anëtar i OKB, për të përshpejtuar procesin e integritimit të Kosovës në BE dhe në paktin NATO. Për të siguruar vendin e merituar të Kosovës në arenën ndërkombëtare", - tha Thaçi.

'Koha Ditore'. Në një konferencë shtypi organizuar të mërkurën, presidenti ka thënë ta ketë mandatin e edhe obligimin kushtetues që ta përfaqësojë shtetin e Kosovës në arenën ndërkombëtare, e edhe t'i prijë deri në fund dialogut me fqinjin verior. E ka deklaruar këtë, vetëm një ditë pasi ai dhe presidenti serb, Aleksander Vuçiç, kanë marrë ftesën nga përfaqësuesja e lartë e Bashkimit European, Federica Mogherini, që më 24 qershor të marrin pjesë në takimin e parë të fazës përfundimtare të dialogut Kosovë-Serbi, i cili do të finalizohet me një marrëveshje ligjërisht detyruese.

SHKURT

Austria kërkon mbështetjen e Italisë për kampet e emigrantëve

Austria kërkon mbështetjen e Italisë për planin e saj për kampet e emigrantëve në Ballkan. Zv/kancelari austriak Heinz-Christian Strache shkoi për të takuar homologun e tij populist italian Matteo Salvini, i shoqëruar edhe nga ministri i Brendshëm Herbert Kiki. Projekti austriak parashikon sjelljen në vendet ballkanike të 600 mijë refugjatëve dhe emigrantëve të dyndur gjatë tre viteve të fundit në Europë për të kërkuar azil. Mbështetjet ka edhe nga Danimarka e Holanda. Në këmbim, vendeve të Ballkanit u jepet mbështetje e veçantë për proceset integruuese europiane. Salvini nuk është kundër idesë së kampeve. Por kërkon ato të ndërtohen në Afrikën e Veriut, për të penguar emigrantët që në burim. Zv/kryeministri italian tha se do t'i kërkonte blindimin e kufijve europianë për emigrantët, duke marrë shembullin e disa vendeve ballkanike. Për këtë kërkon ndryshim të rregullave të Shengenit. Me këtë platformë, populistët e qeverive të Austrisë e Italisë kërkojnë të parqiten në samitin e fund muajit në Bruksel. Por projekti mund të hasë në kundërshtimin e dyshes Merkel-Makron. E duke pasur parasysh këtë, Salvini paralajmëron braktisjen e samitit të 28 qershorit në Bruksel.

Bëhet nënë për herë të parë kryeministria e Zelandës së Re

Kryeministria e Zelandës së Re Jacinda Ardern ka lindur femijën e saj të parë, një vajzë që peshon 3.31 kg. Kjo e bën arë udhëheqësen e dytë në historinë moderne që lind gjatë kohës që është në detyrë. Ardern u shtrua në një spital në qytetin e Auckland mëngjesin e së enjtes. 37-vjeçarja do të marrë gjashtë javë pushim dhe ia ka kaluar detyrat e saj zëvendëskryeministrit Winston Peters. Megjithatë, ajo tha se do të mbetet përgjegjëse duke vazhduar të lexojë dokumentet e kabinetit gjatë kohës që është e angazhuar me përkuqdesjen e vajzës të porsalindur.

Zoran Zaev: Ja kur do anëtarësohet Maqedonia në NATO

Marrëveshja për emrin, Athina s'ka njoftuar BE dhe NATO-n për zhbllokimin e proceseve

E dhe pse është bërë nënshkrimi i marrëveshjes Maqedoni-Greqi lidhur me emrin, Athina ende s'ka njoftuar BE-në dhe NATO-n se mbështet fillimin e negociatave për anëtarësim të Shkupit. Ndonëse sipas Marrëveshjes për emrin sapo Kuvendi i Marrëveshjes në Kuvendin grek. Nëse Cipras nuk e pranon propozimin për 180 deputetë, atëherë ne nuk do të qëndrojmë në qeveri", - tha Panos Kamenos.

PANOS KAMENOS

"Nuk pajtohem me marrëveshjen. Kërkojmë 180 deputetë dhe publikisht zotohemi ta pengojmë ratifikimin e Marrëveshjes në Kuvendin grek. Nëse Cipras nuk e pranon propozimin për 180 deputetë, atëherë ne nuk do të qëndrojmë në qeveri", - tha Panos Kamenos.

nuk kanë të ndalur. Lideri i partisë "Grekët e Pavarur", Panos Kamenos jo vetëm që nuk do ta votojë, por kërkon që në vend se me 151 vota, marrëveshja të kalojë me 180. "Nuk pajtohem me Marrëveshjen, kërkojmë 180 deputetë dhe publikisht zotohemi ta pengojmë rati-

fikimin e Marrëveshjes në Kuvendin grek. Nëse Cipras nuk e pranon propozimin për 180 deputetë, atëherë ne nuk do të qëndrojmë në qeveri", - tha Panos Kamenos, Grekët e Pavarur. Kamenos ndër tjera i drejtoi pyetje partisë më të madhe opozitare, Demokratisë së Re,



Zoran Zaev

nëse mbështet ose jo një emër të përbërë, erga omnes. Nga Demokracia e Re merr kundërpërgjigje të prerë. Pavarësisht qëndrimeve kundër marrëveshjes, partia në pushtet, Syriza është e bindur se do të ketë shumicën e nevojshme parlamentare për ta ratifikuar Marrëveshjen, pasi Shkupi të përfundojë me referendumin dhe ndryshimet kushtetuese, shkruan Alsat M. Nga ana tjetër, kryeminis-

tri maqedonas, Zoran Zaev ka folur për "Al Jazeera Balkan" se kur Maqedonia do të bëhet anëtare e NATO-s, pas nënshkrimit të marrëveshjes për emrin me Greqinë. Ai tha se shpreson se vendi më 12 dhe 13 korrik në Samitin e NATO-s do të marrin ftesën për anëtarësim. "Pasi që të marrim ftesën për anëtarësim, më së paku për një vit e gjysmë vëndi do të bëhet anëtar i 30-të e Aleancës Veriatlantike", - theksoi Zaev. Ai theksoi se marrëveshja e nënshkruar në Prespë është historike dhe ishte e nevojshme për Maqedoninë. Me marrëveshjen e re emri i ri është Republika e Maqedonisë së Veriut.

16 vjet në krye të Turqisë, ç' pritet të ndodhë në 24 qershor

A mund të humbasë në zgjedhje Recep Tayyip Erdogan?

Opozita e motivuar, ja kush është pretendent

Marrë nga Dewtche Welle

Të gjitha zgjedhjet që janë zhvilluar 16 vjetët e fundit në Turqi i ka fituar Recep Tayyip Erdogan. Megjithatë për shkak të krizës ekonomike ka rrezik që ai t' i humbasë zgjedhjet që pritet të mbahen më 24 qershor. Në këtë datë në Turqi do të zgjidhet një parlament dhe presidenti i ri. Sipas sondazheve 45 deri 55 përqind e të pyeturve kanë thënë se duan t' ia japin votën mbajtësit aktual të pushtetit, Recep Tayyip Erdogan. Por në të vërtetë ai mund të marrë shumë më pak vota. Hakan Bayrakç, që ka krijuar Institutin për kërkimin e opinionit publik, SONAR, thotë se ata që janë në pushtet në Turqi kanë krijuar një atmosferë frike, dhe si pasojë gati 10 përqind e zgjedhësve nuk tregojnë hapur për kë duan të votojnë. Në sondazhe ata japin të dhëna të gabuara, prandaj thotë Bayrakç, ka shumë të ngjarë që rezultatet e zgjedhjeve të jenë të ndryshme nga vlerat që kanë nxjerrë sondazhet. Që prej reformës kushtetuese, që Turqia kreu më Prill 2017 me anë të një referendumi, votuesit kanë të drejtë të japin dy vota. Njëra votë vendos kush do jetë presidenti i shtetit, vota tjetër cilat parti futen në parlament. Për Erdoganin, që nuk ka humbur asnjë nga zgjedhjet 16 vjet me radhë, këto zgjedhje duhet të jenë më të vështira e karrierës së tij politike. Që prej fitores së tij të parë në zgjedhjet e 2002, partia e tij islamiko-konservatore AKP ka pasur fjalën në Turqi. Por edhe partia vetë ndodhet para zgjedhjeve të vështira për të.

Problemet në vend janë ashpërsuar
Özer Sencar krijuesi i institutit për studimin e opinionit publik, Metropoll, ndjek prej 25 vjetësh karrierën e Erdoganit. Deri tani nuk ka pasur asnjëherë fushatë më të keqe zgjedhjesh se kjo e tanishmja, thotë ai. Axhenda nuk përcaktohet më prej Erdoganit, dhe ai nuk tregon më vizione për të ardhmen. Kur prezantohet në publik ai duket pa pasion dhe i dobët. "Ai nuk ka bërë kurrë qa shumë gabime në fjalimet e tij" thotë Sencar. Ai ka dyshime nëse Erdogan do mbajë pushtetin apo jo. Erdogan ka 16 vjet në pushtet dhe shihet si më i fuqishmi në politiken turke. Suksesi i tij më i madh ka qenë hovi ekonomik. Në më shumë se një dekadë të ardhur mesazhet e rritjen nga 3500 në 11 mijë dollarë në vit, dhe në gjithë vendin



Kuvendi i Turqisë

pati një boom ndërtime. Por sot ekonomia turke nuk është më në gjendje të mirë. Që prej përpjekjes për puç më korrik 2016 dhe gjendjen e jashtëzakonshme që pasoi atë, lira turke humbi gati 30 përqind të vlerës. Në vend nuk ka më investime. Besimi i tregjeve ndërkombëtare tek ekonomia turke ka rënë. Erdoganit, i cili refuzon të vendosë përqindje për arsye të bindjeve politike, iu desh të mbyllte sytë javën e kaluar kur Banka Qendrore turke rriti përqindjet. Mbas Argjentinës, Venezuelës dhe Iranit, Turqia është vendi i katërt me përqindjet më të larta. "Kjo është hera e parë në 16 vjet kur Erdogan nuk është duke pasur më sukses. Ai nuk e drejton dot më ekonominë. Edhe problemet në sistemin e shëndetësisë dhe atë të arsimit janë shtuar," thotë Sencar. Si pasojë populli turk është duke ndier krizën ekonomike. Prandaj shihet pak pasion në aktivitetet e Erdoganit në fushatën zgjedhore.

Opozita gjithnjë e më shumë e motivuar
Edhe Gülfem Saydan Sanver mendon se Erdoganin e ka të vështirë t' i japë mesazhe popullit të tij. Ajo është eksperte që ka mbrojtur një punim të doktoraturës me temën "Sukseset e AKP në zgjedhje" dhe ka marrë

çmimin Pollie Aëard der "American Association of Political Consultants". Sanver mendon se teatri me një person që është duke bërë Erdogan në partinë e tij, i është kthyer në disfavor. "Në mitingje dhe në fjalimet që mban, ai del i vetëm dhe nuk ka më mesazhe për të dhënë", thotë Sanver. Ndërkohë, Muharrem Ince, kandidat për president i partisë opozitare CHP, ka arritur kohët e fundit të rrisë në sondazhe përqindjen mbi 30 përqind. Kështu është rritur motivimi i opozitës për të fituar zgjedhjet. "Erdogan mundohet tani t' i shërbejë frikërave të zgjedhësve konservatorë," thotë Sanver. Prandaj Erdogan ka folur ditët e fundit në fjalimet e fushatës për operacione ushtarake kundër partisë kurde PKK, në veri të Irakut. Kështu ai nxit frikën tek zgjedhësit, thotë Sanver. Zgjedhësit e frikësuar tremben nga ndryshimi i pushtetit dhe do ia japin votën presidentit aktual.

Fundi i sistemit të fortë presidencial?
Sipas sondazheve Erdogan megjithatë mund t' i fitojë zgjedhjet presidenciale në raundin e dytë. E ashtuquajtura "aleanca republikane" që përbëhet nga AKP dhe MHP, mund të humbasë shumicën në parlament. Atëherë Erdogan nuk do të

kishte më bazën e pushtetit. Sistemin e fortë presidencial në të cilin opozita shikon një diktaturë, do kthehet në ëndërr për Erdoganin. "Nëse AKP humbet shumicën në parlament, atëherë edhe për Erdoganin do vinin ditë të vështira," thotë Sanver. Mbas gjendjes së jashtëzakonshme Erdogan nxorri ligje dhe dekret për të mbetur në qeverisje. "Nëse AKP nuk ka më shumicën në parlament, atëherë Erdogan do humbiste pushtetin që ka sot, edhe nëse rizgjidhet si president. Ai nuk do jetë më president efektiv dhe ai do duhet të njohë pushtetin e parlamentit," thotë ekspertja.

Zgjedhjet në Turqi, opozita bashkohet ndaj Erdoganit
Partitë kryesore opozitare në zjrrtarisht një aleancë të gjërë elektorale para zgjedhjeve të qershorit, një hap që mund të përbëjë një rrezik serioz për dominimin e partisë qeverisëse të Erdoganit. Marrëveshja, e cila përfshin blloqet më të mëdha laike dhe nacionaliste të vendit, pritet të demtojë rëndë kontrollin absolut të "Partisë Drejtëse dhe Zhvillim" të presidentit turk. Koalicioni, që do të prezantohet formalisht të enjten, përbëhet nga Partia Republikane e Popullit, Partia e Mirë, Partia islamiste "Saadet" dhe Partia

Demokratike. Republikanët laikë janë partia më e madhe opozitare në Parlament dhe udhëhiqen nga Kemal Kilicdaroglu, ndërsa nacionalistët kanë formuar se fundi grupimin e tyre të quajtur "Partia e Mirë", nën drejtimin e Meral Aksener, e cila e shpalli veten edhe kandidatë presidenciale. Presidenti Erdogan shpalli zgjedhje të parakohshme parlamentare dhe presidenciale më 24 qershor, një vit e gjysmë më herët. Kushdo që do të zgjidhet president, do të ketë fuqi të jashtëzakonshme për shkak të ndryshimeve që u miratuan me referendumin e vitit të shkuar. Erdogan është favoriti për presidencën, megjithëse zgjerimi i bllokut opozitar përbën një sfidë të madhe. Ndërsa të zgjedhjet parlamentare, situata e partisë qeverisëse "AKP" është edhe më e vështirë përballë një opozite të bashkuar. Në Turqi, nëse një parti nuk ka 10% të votave nuk hyn në Parlament, por për të shpëtuar aleatin e vogël "MHP", partia e Ergodanit lejoi aleancat elektorale, hera e parë në vend. Analistët thonë se Erdoganin me sa duket nuk e kishte parashikuar një organizim të tillë të opozitës, të cilës sapo iu dha mundësia të bashkohej, e shfrytëzoi me shpejtësi.

SHKURT

Turqia nis me tarifën hakmarrëse kundër SHBA-ve

Si përgjigje ndaj taksave që u ka vënë SHBA-ja importeve të Turqisë të aluminit dhe çelikut, kjo e fundit do të nisë të zbatojë tarifa kundër SHBA-së. Ministri turk i Ekonomisë, Nihat Zeybecku, tha se, nga sot, tarifa do të vihen mbi importet e qymyrit, letërës, arrave, bajameve, duhanit, orizit të papërpunuar, ushqit, automobive dhe kozmetikës. Vendimi vjen pasi presidenti amerikan, Donald Trump, vendosi taksë 25% mbi importet e çelikut dhe 10% mbi ato të aluminit nga Evropa, Kanada, Meksika dhe aleatët e tjerë të SHBA-së. Shtetet e Bashkuara janë vendi i pestë më i madh ku Turqia eksporton mallrat e saj dhe vëllimi i tregtisë, në vitin 2017, ka arritur në 20.6 miliardë dollarë. Nga nesër, tarifa hakmarrëse kundër SHBA-së do të nisë të zbatohet edhe Bashkimi Evropian. Ekspertët kanë tërhequr vërejtjen për luftë të mundshme tregtare.

Dyshohet për korrupsion, gruaja e Netanyahu nën hetim

Bashkëshortja e kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu, Sara Netanyahu, është vënë zjrrtarisht nën akuzë për korrupsion dhe shpërdorim fondesh publike. Akuzat i ka ngritur prokuroria e Jeruzalemit që akuzon bashkëshorten e kryeministrit se ka falsifikuar shpenzimet në rezidencën kryeministrale, duke shpërdoruar 130 mijë euro nga fondet shtetërore. Dokumentet tregojnë se shumica marramendëse është shpenzuar gjatë periudhës mes viteve 2010 - 2013. Ajo ka mashtruar kur ka thënë se rezidenca qeveritare nuk ka të punësuar kuzhinierë. Ndërsa ka deklaruar se paratë publike i ka shpenzuar për shërbime katering. Zonja Netanyahu i ka hedhur poshtë akuzat, duke i quajtur "shantazhuese". Prej vitit 2017 edhe bashkëshorti i saj kryeministrit është zjrrtarisht nën hetim për të paktën 2 raste korrupsioni.

Maqedoni, digjen tre fëmijë të mitur

Një tragjedi ka ndodhur ditën e djeshme në një familje në komunën e Veles, në Maqedoni. Një zjarr i ka marrë jetën të vogëlshme, raportojnë mediat maqedonase. Tre fëmijët, të moshës 1,2 dhe 5 vjeçare kanë humbur jetën si pasojë e flakëve që kanë përfshirë banesën e tyre. Ashtu siç shkruajnë mediat lokale, shtëpia në të cilën ka rënë zjarri gjendet në terren jo të përshtatshëm në Veles, çka ka bërë që ndërhyrja e forcave të zjarrfikëses të jetë e vështirë. Zjarrin është pikasur nga banorët e zonës të cilët kanë bërë të mundur njoftimin e policisë. Policia është në terren dhe po kryen ekspertizë për zbardhjen e shkaqeve të zjarrit.

LUFTA KUNDËR FESË

1967, lufta kundër fesë edhe me tanke e topa

Nga: Ylli Polovina

Si u shembën minaret e xhamive në Shkodër dhe u zhdukën Çetirët në Berat

Tërë viti 1967 ka qenë për shqiptarët një i ngjashëm me përsëritjen e një përmbyseje sociale. U quajt atëherë "revolucion kulturor". Siç doli më pas, qe një variant i ndikuar edhe prej atij kinez, maqedonian. Kataklizma shoqërore ndodhi që në janar, kur të rinjtë e gjimnazit durrask "Naim Frashëri" (vetvetiu siç thonë një palë, të komanduar siç këmbëngul një grup tjetër), shpallën nismën "Të luftojmë deri në fund ideologjinë fetare, besëtytnitë, zakonet prapanike". Më 6 shkurt Enver Hoxha u hodh në veprim dhe lëshoi në publik silurën e fjalimit "Revolucionarizimi i mëtejshëm i partisë dhe pushtetit". Dy ditë më vonë "Zëri i Popullit" i dha mbështetje iniciativës së gjimnazistëve të "Naim Frashërit". Në titullin e editorialit të saj politik redaksia e gazetës së Komitetit Qendror të PPSH-së përdori termin "shpatë e mprehtë". Përkishtë kjo, shpata me teh të mprehur mirë, e cila pas vitit 1944 ishte përdorur ndaj "armiqve të klasës", do të fishkëlente këtë herë mbi kokat e "ideologjisë fetare, paragjykimeve, besëtytnive dhe zakoneve prapanike". Kështu qe shpallur një luftë totale, në thelb mjaft e çuditshme dhe e jashtëzakonshme, e pafomular kurrë më parë në ndonjë rresht të doktrinës së Marksit dhe të Engelsit, madje as të Leninit dhe po ashtu Stalinit. Kjo do të qe vetëm e Enver Hoxhës. Objektivi i saj: Shqipëria do të shndërrohej në vendin e vetëm në botë pa asnjë institucion fetar. Ndërkohë në 6 shkurt 1967 besimtarët myslimanë kishin një rrjet shumë të dendur xhamish. Mes qyteteve kampione qe Dibra me 122 të tilla. Kishat katolike numëronin vetëm në Shkodër 67, kurse ato ortodokse në Korçë kulmonin në 122. Më tërësisht gjithë vendi kishte 2172 faltore, ku xhami qenë 740, kisha ortodokse dhe manastire 609, kisha katolike 158. Ndërkohë 530 ishin teqe, turbe dhe mekame. Klerikë që ushtronin profesionin e hoxhës apo të priftit qenë 912. Purga e madhe revolucionare zgjati 6 muaj. Në 30 gusht 1967 aparatit i Komitetit Qendror të partisë së vetme në pushtet, PPSH, bëri një bilanc. Gjithçka qe kthyer në zero, faltore dhe klerikë, besimtarët, gjithashshëndeti një gjimnazist durrask, i cili në periferi të qytetit jo vetëm mori kazmën për të shkatërruar një kishë, por edhe e tërhoqi zvarrë priftin. Shehu në një rast tjetër pati telefonuar Ramiz Alinë që t'i hyhej me kazma xhamisë së Ethem Beut në qendër të Tiranës, pranë Kullës së Sahatit. Sipas tij, ajo duhej të shembej. Alia kërkoi kohë t'i telefononte Enver Hoxhës dhe ky e ndaloi prerë çdo dhunim të ndërtesës së asaj xhamie. Por kur Mehmet Shehu në ditën e parë të shpërthimit të nismës "shpatëmprehtë" kundër fesë dhe institucioneve të saj u rikthye në mbremje në shtëpi, e ëma, Sulltana, gati u hodh në fytyrë: Po me xhamitë ç'patët? Atëherë kryeministri, i cili nuk guxoi t'ia kthente nënës së vet, në zemërim e sipër telefonoi ministrin e Mbrojtjes, Beqir Ballukun, dhe u ulëriti: Po t'i ç'pate që i nxore tanket? Çfarë kishte ndodhur qe krejt e pabesueshme. Në Shkodër minaret e dy xhamive në qendër të qytetit ishin rrëzuar, duke u lidhur me kavo e tërhequr prej tankesh. Kurse në qendër të Fierit kisha e Shën Gjergjit u rrëzua me diagaqe të ushtrisë, deri sa u rrafshua fare. Para se të ndodhte kjo sek-

retari i parë i PPSH për rrethin, Piro Gusho, pati telefonuar Enver Hoxhën për ta shpjeguar çfarë kishin ndërmend, por shefi i partisë tha se ajo kishte afreske dhe mirë qe të ruhej. Gusho rezistoi: nuk e mbaj dot rininë. Kështu u zhdukën piktura shumë të çmuara të vëllezërve Çetiri. **PRANË KISHËS SË SHËN ANDOIT, TOPA DHE MORTAJA** Përdorimi i mjeteve ushtarake në luftë kundër fesë nuk ka ndodhur vetëm në Shkodër dhe Fier. Do t'ju rrëfejme një rast tjetër edhe më të qartë. Kjo ndodhi me Kishën e Shën Andoit në Laç. Burimi i të dhënave për këtë është një libër kujtimesh i një ish-partizani 15 vjeçar, më pas oficer karriere. Quhet Naxhi Zhupa. Në faqet 162-166 të librit të vet kësaj ngjarjeje ai i kush-ton vendin kryesor. Të dhënat e nxjerra prej tyre do t'i plotësonim më pas, për qëllimet e këtij shkrimi, me disa takime dhe biseda të tjera me të. Ajo që ka ndodhur vërtet është e paprecedent. Pasi paraqet çfarë u kishte treguar prifti i kësaj kishë për Shën Andoin (Sant Antonin), i cili në mes të shekullit të trembëdhjetë, lindur në Portugal dhe më pas emigruar në Itali, kishte qenë një besimtar, pastaj i shenjtë, mbrojtës i të varfërve, Zhupa shkruan: "...njëri prej

tetit të Partisë së Krujës, Lefter Goga, i cili kërkoi nga Komanda e Brigadës që zona përreth Kishën së Shën Andoit në një reze 3-4 kilometra, të shpallej zonë ushtarake, prandaj edhe të ndalohej hyrja e çdo civilu ose besimtari brenda asaj zone. Natyrisht që u diskutuan shumë mendime dhe u konkludua që të zbatohej ideja e sekretarit të partisë dhe territori në fjalë të shndër-rohej në Poligon Qitjeje të Përhershme për artilerinë. Kështu që në ditët në prag, gjatë dhe pas festës së Shën Andoit, zhvillo-heshin qitje reale artilerie në atë zonë, duke vendosur njëherësh roje fikse në të gjitha drejtimet që të çonin në Kishën e Shën Andoit". Vijon më pas Naxhi Zhupa: "Mua, meqenëse isha shef i artilerisë, mu kërkua mendimi, se si mund të realizo-heshin qitjet e parashikuara në programin vjetor të qitjes. U ktheva përgjigje të pranishmëve se qitjet në atë zonë dhe në atë terren ishin "ideale", sepse përmubusheshin më së miri kushtet që kërkonte "Kursi i qitjes", porse duhet domosdoshmërisht një vendim dhe miratim nga Komiteti Ekzek-utiv i Krujës që ky rajon është "Poligon qitjeje i përhershëm", dhe njëherësh të lajmërohen këshillat e fshatrave të zonës për këtë vendim. Po ashtu vendimit t'i bash-



Foto 3. Pamja jugo


mbremjen e datës 12 qershor repartet e artilerisë zunë pozicionet e zjarrit në verilindje të fshatit Gjorm e Sanxhak, dhe në mesnatën e dt. 12-13 qershor, filluan qitjet natën sipas planit". Pastaj thekson: "Në mëngjes më 13 qershor qitjet u intensifi-kuan dhe batalioni i xhenios në anën veri-ore, që të shpie tek Kisha e Shën Andoit, filloi "shkatërrimin" fushor për qëllime "mësimore". Në shënime me shkrim të kë-tyre ditëve të fundit ai saktëson se batalio-ni xhenior nuk e preku fare ndërtesën e kishës dhe me dinamit nisën të hapnin rrugën, e cila të çonte deri aty. Më parë ai qe shteg. Sigurisht planifikohje që faltorja e krishterë, tërheqëse si magnet e mijëra



Në foto: Naxhi Zhupa

objekteve të kultit të tij, si në tërë botën, ku ngrit edhe në Kurbin". Qe 600-700 me-tra në lindje të majës së Divës, e ndërtuar në majën e një shkëmbi, tamam si kalatë e dikurshme". "Në majë të Divës, shpjegoi Naxhi Zhupa, ishte një prej kalave të vje-tra lire". Çdo 13 qershor në këtë kishë bëhej pelegrinazh dhe vinin jo pak, por lumenj me njerëz, me mijëra besimtarë, mbërrin-in aty të nisur nga zonat përreth e prej tërë-vevrit të vendit. Ishte pa dyshim pelegrin-azhi më i madh fetar vjetor i shqiptarëve. "Në kuadër të "Luftës kundër zakoneve prapanike dhe fesë, nënvizion autori, u mend-ua që edhe kjo qendër fetare të mbyllej. Për këtë qëllim 3-4 ditë para 13 qershorit, një mëngjes herët, erdhi në Komandën e Brigadës së Laçit, sekretari i parë i Komi-

këngjiten dokumentet e tjera me firmë e vulë, të cilat duhet të jenë gati dy ditë për-para datës 13 qershor. Sekretari i Parë i Partisë plotësimin e kësaj kërkesë e mori vetë përsipër dhe duhet të pohoj se në 11 qershor ato erdhën në Komandën e Brigadës në Laç, ndërkohë edhe unë kisha lajmëruar dhe ishte gati për qitjet vjetore Grupi i Mortajava 120 m/m në Mamurras si edhe artilerinë e dy batalioneve të këmbë-sorisë, përkatësisht nga dy bateri për çdo batalion". Këto ditë në disa shënime me shkrim në përgjigje të kërkesës tonë se sa gryka zjarrt ishin, Zhupa informoi se grupi i artilerisë së Brigadës kishte 12 mortaja 120 m/m dhe dy batalionet këmbësore që morën pjesë në qitje, 16 topa. Shkruan më poshtë në librin e tij Naxhi Zhupa: "Në



Në foto: Fronti Demokratik kërkon Shpalljen e Kishës zonë ushtarake

besimtarëve, të mbyllej e të shndërrohej në pikë hapjeje ushtarake për vetë batalionin xhenior, çfarë edhe ndodhi.

KU PËRFUNDI STATUJA PREJ DRURI E SHËN ANDOIT Shkruan në vazhdimin e rrefimit të vet ish-partizani 15 vjeçar, i plagosur rëndë në çlirimin e Tiranës dhe ende me copë predhe në njërën gju, pjesëmarrës luftimesh deri në Jugosllavi, Naxhi Zhupa: "Ditën e 13 qershorit (ndërkohë që në afërsi të Kishës së famshme françeskanë kishin mbërritur shumë besimtarë-shënimi ynë) e mbyllëm pak a shumë "në paqe", pa asnjë incident me besimtarët e ardhur, por shkatërrimi skandaloz i Kishës së Shën Andoit, që edhe objekt me vlera të veçanta historike, vazhdoi, sepse atje, me sa kisha pasur rastin të shihja, kishte ikona fetare të rralla, por kishte edhe të tjera të pikturuara të ndërthurura me vlera artistike dhe historike. Në të ndodhej edhe një bibliotekë

Opinion i Ditës

A mund të presë Shqipëria 600 mijë refugjatë?

Nga Ilir Kalemaj

(vijon nga faqja 1)

... përbashkët të formuluar nga Komisioni Europian, ku theksoheshin shkurtimisht drastik i përfitimëve për azilantët, deportimi i menjëhershëm i kandidatëve të pasuksesshëm dhe kontrolli rutinor si në kufijtë e brendshëm, ashtu edhe brenda shteteve anëtare. Barra nuk iu lehtësua vendeve hyrëse si Italia përkundër qëndrimit të ashpër që ka marrë kjo e fundit nëpërmjet ministrit të ri të Brendshëm të Legës, Salvini. Por nga ana tjetër, mund të quhet një fitore taktike e kancelares Merkel, që gjendet përballë një sfide nga ministri i saj i Brendshëm dhe partnerja tradicionale e kristian-demokrates, CSU-së bavareze, që ka marrë një qëndrim shumë më të ashpër ndaj refugjatëve dhe propozon kthimin e tyre në kufi. Kjo së bashku me arrijetën e një akordi tjetër të kancelares me presidentin francez Macron, të arritur po këtu ditë mbi buxhetin, por edhe më e rëndësishme mbi paketën e ndërhyrjes për konsolidimin e eurozonës nëpërmjet një kompakti fiskal që ka qenë një kërkesë e hershme e Elizesë, synojnë të përfutojnë kapital politik si në Paris, edhe në Berlin dhe të synojnë udhëtimin në ujëra të qeta për të ardhmen e afërt.

Por, në takimin e fundit u diskutua edhe dërgimi i emigrantëve të kapur në dete në vende kufitare me BE-në, në qendrat e pritjes, që mendohet të organizohen në të ardhmen e afërt aty. Kjo është në



linjë me atë që fillimisht "Le Monde" raportoi për Shqipërinë dhe që e mirënjohura "Politico Europe" përsëriste para disa ditësh, ku Shqipëria dhe Tunizia ishin destinacionet e vetme të konsideruara deri tani nga Brukseli zyrtar. Për ta konfirmuar edhe më tej, ishte deklarata e nxituar dhe sfiduese e zv.ministrit të Brendshëm të Shqipërisë, që theksojnë në një intervistë për një të përditshme gjermane që Shqipëria është gati të presë 600 mijë refugjatë.

Menjëherë më pas, në filtrat e debatit publik u pozicionuan si rëndom në këto raste dy kampe diametralisht të kundërt, ku e përmbledhur njëra palë pasqyron të rrezikun në terma, që shpesh

kalonin dhe në racizëm të hapur dhe një lloj ksenofobie të theksuar, kurse tjetra përdorte argumente konfuze që varionin nga detyrimi solidar i Shqipërisë si një vend që vetë ka 100 milionë emigrantë të shpërndarë nëpër botë, deri të mbitheksimi i detyrimit humanitar që ka Shqipëria në këtë rast apo të më cinikët që shihnin përfitimë financiarë nga kjo punë.

Mendoj që kanalizimi i debatit në këto hulli të kithta, por edhe të njëtrajtshme që e shohin vetëm bardh e zi situatën nga pozicione partizanë nuk i shërben debatit për informimin e publikut, një lloj sikundër deklaratat kontradiktore të qeverisë, e cila po luan një kumar diplomatik me këtë çështje, duke e lidhur ngushtësisht me

hapjen e negociatave dhe duke synuar të përfitojë në secilin rast. Shkurtimisht, argumentet pse Shqipëria nuk mund të bëhet urë pritëse e 600 mijë refugjatëve janë: 1. Këtu nuk bëhet fjalë për refugjatë që synojnë të aplikojnë për azil politik në Shqipëri apo edhe ata që kalojnë transit, që llogariten në një numër krejtësisht periferik rreth 2 mijë përgjatë këtij viti, kryesisht në muajt maj-qershor. Por, bëhet fjalë që Shqipëria të përdoret si vendgrumbullimi i refugjatëve të kthyer nga BE pas azilit të pasuksesshëm, gjë që shton gjasat për elementë problematikë. 2. Çdolloj krahasimi me krizën humanitare të vëllezërve kosovarë që u spastruan etnikisht nga gjenocidi Millosheviçian e bën paradoksale dhe është në vetvete ose mallinje, ose idioteske nga mosnjohës së rrethanave specifike gjeopolitike, kulturore etj. 3. Ka një dallim esencial mes refugjatëve të luftës të ikur nga vende të konfliktit si Siria, Iraku apo Libia, numri i të cilëve jo vetëm është në rënie, por edhe kanë disa nga kategoritë e azilantëve të vërtetë dhe meritore, por edhe janë lehtësisht të asimilueshëm për shkak të edukimit të tyre, zetjeve dhe aftësi për t'u përshtatur dhe kategorive më problematike si pakistanez apo afganë, të paktën duke iu referuar precedentëve në vendet e BE-së dhe është mirë të mësojmë nga eksperiencia. 4. Karta e votofimit përfid dhe të pakonsultuar të ndërtimit të tyre, zetjeve në Shqipëri përkundër "karrotës" së hapjes së negociatave është e rrezikshme, e painformuar dhe infantile si taktikë negociatore. 5. Ndry-

shimi kompozicionit demografik dhe aftësia përthithëse e Shqipërisë së rrudhur që po zbrazet me shpejtësi nga banorët e saj që po ikin si të ndërkyer në përpjekje për të siguruar pak dinjitet dhe siguri rrugëve të Europës.

6. Krahasimi me Turqinë dhe krizën humanitare që asaj i duhej të përballonte kur rreth 2 milionë sirianë kapërcyen kufirin të detyruar nga konflikti dhe aftësia e Turqisë për të arritur një marrëveshje të drejtë me Brukselin për rreth 2 miliardë euro janë të paaplikueshme për shumë arsye me Shqipërinë. E para, sepse 600 mijë emigrantë të vetëftuar nga qeveria shqiptare proporcionalisht janë bombë demografike krahasuar me 2 milionë sirianë përkohësisht të strehuar në Turqi dhe të detyruar nga rrethanat të kapërcenim kufirin. E dyta, sepse ekonomitë e të dyja vendeve dhe aftësitë ekonomike nuk kanë të krahasuar. E treta, sepse aftësitë e diplomacisë sonë për të negociuar marrëveshje të drejta lënë krejtësisht për të dëshiruar. Dhe e fundit, sepse këtu ka mungesë transparence dhe informimi të opinionit publik, si dhe mungesë ekspertize të certifikuar për të kryer bilancet në avancë. Thënë kjo, çdo lloj kanalizimi i kundërt rreth diskutimeve mbi racën, ngjyrën, etninë apo kulturën e emigrantëve apo të tjera konotacione me sfond racist apo përhapje të alarmeve me natyrë ksenofobike, jo vetëm nuk i shërben debatit, por e fut në shtigje të rrezikshme, të parakohshme dhe jo utilitare për debat publik dhe politik.

Opinion i Ditës

Nga Alfred Cako,

kryeauditues në KLSH

Si duhet të veprojnë ZVRPP-të me taksën e kalimit në pronësi të ambienteve të përbashkëta?

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), përveçse propozon dhe këshillon për ndryshime ligjore dhe ndryshime të tjera sa herë që ka dispozita ligjore bllokuese apo një vakum ligjor, ai është një gardian për rritjen e standardeve të respektimit të kuadrit ligjor ekzistues dhe ndaljen e gabimeve, keqinterpretimeve apo edhe abuzimeve me këtë kuadër ligjor. Në këtë kuptim, mund të analizojmë një aspekt të rëndësishëm të keqinterpretimit apo abuzimit me ligjin nga ana e Zyrrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive (ZVRPP-ve), gjatë regjistrimit të pasurive në procesin e kalimit të pronësisë në lidhje me taksën për kalimin në pronësi të ambienteve të përbashkëta. Ka një shqetësim dhe interes të mirëkuptuar prej KLSH-së nga ana e shoqatave të ndërtuesve, ose të bizneseve që operojnë në fushën e

ndërtimeve, të cilat i janë drejtuar edhe KLSH-së me kërkesë për konsultime me argumente jo ligjore për të intimiduar veprimet e saj gjatë auditimeve në Zyrrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive. Në të njëjtën gjatësi vale me ndërtuesit janë edhe punonjësit e ZVRPP-ve, që kanë sjellë një reagim kundërshtues të paargumentuar në ligje nga ana e tyre në lidhje me kërkesën këmbëngulëse të KLSH-së që të rikuperojnë dëmin ekonomik të shkaktuar në buxhet dhe që të ndryshojnë dhe të marrin në konsideratë në të ardhmen edhe trajtimin e taksës së ambienteve të përbashkëta gjatë regjistrimit të pasurive, duke i sjellë kështu arkës së shtetit të ardhura të konsiderueshme të munguara në mënyrë abuzive dhe korruptive.

Shkelja e këtij kuadri rregullar



tor në mënyrë spekulative dhe korruptive, sigurisht që ka kohë që po goditet hap pas hapi nga ana e KLSH-së, duke ardhur në ndihmë

të buxhetit dhe interesit shtetëror e publik e duke ngritur edhe në këtë aspekt kërkesat për standartet e punës së ZVRPP-ve.

Por të flasim pak më teknikisht mbi problemin me gjuhën e argumenteve ligjore mbi pretendimet e ndërtuesve të ZVRPP-ve kundër kërkesës së KLSH-së. Ndaj, kërkesave dhe pretendimeve të bashkuara të mëposhtme në thell të të dyja palëve, me kërkesa me ngjirim paksa të ndryshëm, por synim të njëjtë, përgjigjet e argumentuara të KLSH kanë qenë e do të jenë në thell si më poshtë:

1 - Ndërtuesit ngrënë pretendimin se kërkesa e KLSH-së ndaj Zyrrave të Regjistrimit të Pasurive për taksimin e ambienteve të përbashkëta do të ngrinte më tej koston e ndërtimeve, nuk është e vërtetë, pasi gjatë kontratave ligjore për transferimin e pasurisë nga ndërtuesit tek blerësit e banesave, këta të fundit paguanë sipas përqindjes në kate, edhe përqindjen e ambienteve të përbashkëta,

Kroacia ka shpartalluar Argentinën 3-0, por mbi të gjitha ka treguar të gjitha anët e dobëta të skuadrës së Sampaolit, e cila nuk mund të gjejë shërim as te Leo Messi. Ndeshja nis e fortë dhe Kroacia kërkon menjëherë të vendosë diktatin në fushë, duke përfutur dhe nga paqartësia e mbrojtjes argentinase dhe sidomos e portierit Kabajero. Perisja ka një rast ideal shënimi, por gardiani amerikano-jugor devijon aq sa duhet në këndore, ndërsa

më pas janë vetë argentinasi që ia vështirësojnë punët vetes, por kroatët nuk përfitojnë. Argjentina shfaqet në minutën e 13-të sulm, kur Meca gjuan, por Lovren devijon në këndore. Në të 30'-ën "la celeste" shpërdoron një rast të pabesueshëm kur Perez gjuan jashtë me portën bosh. Takimi është i ndezur dhe ndërhyrjet e ashpra nuk mungojnë, me gjyqtarin Irmatov që lejon lojën e fortë. Pjesa e parë mbyllet në barazim, ndërsa e dyta nis në mënyrë tragjike për Argentinën. Kabajero bën një

Turpërohet Mesi me shokë

Kroaci-Argentinë 3-0, ballkanasit kualifikohen

veprim amatoresk, duke i dhuruar Ante Rebiç një rast të artë shënimi, me sulmuesin që nuk fal dhe kalon Kroacinë në epërsi. Trajneri Sampaoli nuk u beson syve, ndërsa udhëzon të tijtë të dalin para. Argjentina do të përpigjet me një aksion të Higuanit, por Subasiç ndal

Mecën nga fare pranë. Ndeshja ka ritëm dhe Kroacia nga ana tjetër i shkon pranë dyfishimit kur Vrsaljko pason shkurtimit për Manxukuçin, që gjuan rrjetën e jashtme. Argjentina është nervoze dhe ndjen se po i rrëshqet Botërori, ndërsa Kroacia ka qetësinë e

avantazhit dhe në minutën e 80-të godet sërish. Luka Modriç lëshon një të djathtë të shkëlqyer nga jashtë zonës, që siluron Kabajeron dhe e çon ndeshjen në 2-0. Lojtarët argjentinasi i tradhetojnë nervat dhe në minutën e 85-të Irmatov mbase kursen Otamen-

din në gjestin e tij. Nga faulti gjuan Rakitiç, që i shkon pranë golit të tretë kur godet traversën e Kabajeros. Por mesfushori i Barcelonës do ta gjejë golin e tretë, kur do të ketë në dispozicion të gjithë pasqyrën e portës pas asistit të Kovaciçit, kjo falë edhe një mbrojtjeje skandaloze të të besuarve të Sampaolit. Mbyllet 3-0 për Kroacinë në "Nizhni Novgorod" me ballkanasit që kualifikohen me tej, ndërsa për Argentinën duhet një mrekulli.

Mediat zvicerane akuzojnë serbët për politizim të ndeshjes, për shkak të katër shqiptarëve



Jeton Selimi

Ministri Daçiç provokon helvetët: Luajmë me Zvicrën, apo me Prishtinën?

"Kurir": Behrami kërkon të hakmerret

Serbi-Zvicër është kryendeshja e ditës së premte dhe kjo jo vetëm për shkaqe sportive. Në Kombëtaren helvete, Vladimir Petkoviç ka grumbulluar edhe katër lojtarë shqiptarë, të katërt titullarë në ndeshjen e fundit kundër Brazilit dhe siç dihet tashmë, kjo gjë sjell irritim në Beograd, me mediat serbe që nuk humbasin rastin të thumbojnë apo të krijojnë debat nga hiçi. Kështu ka bërë edhe e përditshmja "Kurir", që ende nën hijen e 14 tetorit të vitit 2014, vijon të sajojë artikuj që nuk i shërbejnë askujt, përveçse shtojnë dozën e ksenofobisë dhe urrejtjes. Në shënjestër është Valon Behrami, lindur në Mitrovicë, familja e të cilit vuajti represionin serb dhe u detyrua të emigrojë. "Prindërit e tij vuajtën prej serbëve, ndaj ai ka një motiv të veçantë për të mundur Serbinë. Zyrtarët e përfaqësueses serbe gjithnjë kanë deklaruar se nuk janë të interesuar në politikë, por duket se ndeshja do të përqendrohet aty, pasi edhe mediat zvicerane janë angazhuar në këtë luftë duke cituar tifozët shqiptarë që



duan humbjen e Serbisë", shkruan "Kurir", që më pas citon deklaratat e ndryshme tifozësh, të cilët shprehen se kur luan Zvicra, kanë të njëjtën ndjesi sikur shohin Kosovën. Më zyrtare gazeta

"Blic", e cila në kryelajmin e saj sportiv ka mesazhin e presidentit Aleksandër Vuçiç, që u bën thirrje lojtarëve të përfaqësueses serbe që të lënë shpirtin në fushë, pasi një komb i tëri i

ndjek, ndërsa u ka kërkuar tifozëve që të jenë të shumtë në stadiumin "Samara Arena". Ndërkohë, nga ana e shtypit helvet vijnë akuzat dhe në shënjestër është ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica

Daçiç, që i pyetur përpara ndeshjes për takimin Serbi-Zvicër, është përgjigjur me pyetje, duke mos ndarë politikën nga sporti: "Mos vallë po luajmë kundër ekipit Kombëtar të Prishtinës?", ka thënë Daçiç, që i ka revoltuar jo pak zviceranët. Por Daçiç nuk e ka lënë me kaq. "Politika dhe sporti nuk duhet të jenë të përziera. Por, natyrisht, kjo nuk është e mundur me ndeshjen e së premtes. Sepse ne nuk e dimë nëse luajmë kundër ekipit Kombëtar të Zvicrës, atij Shqipërisë ose të Prishtinës", raporton gazeta "Blic". Ndryshe nga ministri Daçiç, që ka ende në mendje ngjarjet e 14 tetorit të vitit 2014, kur vëllai i Granit Xhakës, Taulanti, rrëmbeu nga duart e Stefan Mitrovicë flamurin e Shqipërisë Etnike çka solli

shpërthimin e vullkanit të urrejtjes, racizmit dhe ksenofobisë së serbëve të pranishëm në stadiumin "Humska", futbollistët nuk duan të përzihen në këtë temë. "Unë jam i sigurt se nuk do të ndodhë prapë. Atëherë ishim naivë, nuk duam të provokohemi. Ne nuk duam të hyjnë në asnjë mënyrë në këtë debat dhe duam vetëm të përqendrohemi te futbollit", deklaroi një nga veteranët e Serbisë, Dushko Tosiq. Të premten në orën 20:00 do të luhet Serbi-Zvicër, ndeshje e vlefshme për grupin E të Kupës së Botës, por fatkeqësisht klima është e tendosur dhe në fushën e lojës, veç 22 lojtarëve dhe topit të rrumbullakët, do të zbrisin edhe tensionet njëzërisht prej historive më të zeza të Ballkanit.

GRUPI D

Francia i bashkohet grupit të skuadrave të kualifikuara që në ndeshjen e dytë të kësaj Kupe Bote, teksa bëhet ekipi i tretë pas Ruisë e Uruguait që kalon, ndërsa Peruja do të luajë për statistika ndeshjen e tretë dhe do të kthehet në shtëpi. Ky është përfundimi i përballes Francë-Peru, me amerikano-jugorët që u përpogon shumë, por pa mundur të zhbënin golin e Mbapës. "Gjelat" e nisnin ndeshjen më mirë dhe krijojnë epërsi në gjysmën e parë të pjesës së parë. Shkëndijën e parë të vërtetë e jep Antuan Grizman, që dety-

Franca kualifikohet, Peruja eliminohet



ron Gajesen të bëjë një pritje shumë të vështirë. Peruja nis të fitojë terren. Pogba lëshon në zonë Zhirun që gjuan, topi devijohet dhe Mbape ndjek aksionin duke shtyrë në rrjetë, 1-0 dhe Kroacia kalon në avantazh. "Gjelat" e mbyllin pjesën e parë në sulm, kur Hernandez në di-

agonale provon dy herë të realizojë, por njëherë grushton Gajese, ndërsa në gjuajtjen e dytë ndërhyjnë mbrojtësit. Pjesa e dytë nis me silurën e Akinjos, që nga distanca e largët gjen traversën e Lorisit. E pafat Peruja, që i shkoj pranë barazimit. Peruja bie fizikisht dhe Franca e mbyll ndeshjen në sulm, me shumë për të mbajtur larg kundërshtarin sesa për të shënuar, ndërsa merr kualifikimin kreun e grupit me 6 pikë, duke detyruar Perunë të bëjë gati valixhet.

GRUPI C


Danimarka e Australia ndahen në paqe



janit duke përshëndetur rrjetën. Vikingët po luajnë më mirë në këto minuta të para, ndërsa Australia do të nisë të dalë nga zona pak nga pak për të kulmur në minutën e 36-të. Top në zonë nga e djathta dhe Leki kërcën më lart duke gjetur dorën e Pelsenit. Kryesorit spanjoll Antonio Mateu thërret në ndihmë VAR-in,

që konfirmon penalltinë për Australinë, të cilën e ekzekuton saktësisht Jedinak. Në çastet e fundit të lojës, danezët provojnë dy herë të prishin ekuilibrat, por pa gjetur kuadrantin. Mbyllet 1-1 në "Samara Arena", një rezultat që i shkon më shumë për shtat Danimarkës, ndërsa Australia mori pikën e parë në këtë Botëror. Gjithsesi, fundi i ndeshjes solli zhgënjim në të dyja kampet, pasi pretenduan maksimumin në këtë sfidë.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Riza aktor.
7. Një fjalë si hiç.
11. Një mund të jetë diplomatik.
12. Premtori të bëhet as.
14. Janë fellinë... të zinj.
16. Ami i Maupassant.
18. Heroi i Emilio Salgarit.
19. Qe anarkisti i famshëm rus
21. Një mungesë gjaku.
22. Susanna shkrimtare
23. Të parat në citisi.
26. Mbyllin një shtëpi.
28. Qendër në kaos.
28. Ka bërë piktoreskë një i tillë
30. Inicialet e Camus.
31. Motra... e Kolë Idromenos
33. Një konfuzion total.
34. Rastet pa set.

36. Rastisin në krye.
37. Fillojnë detyrën.
38. Bektashi këngëtare.
39. Andrea aktore.
41. Sampras i tenisit.
43. Shkroi Korbi (indic).
44. Triolet e Trëndafilë me kredi.
46. Kilmer aktor.
47. Në krye të robotëve.
49. Unë dhe ti.
50. Një mund të jetë fetar.
51. Stephane poet francez

VERTIKAL

1. Fillojnë praktikën.
2. Britma e Arkimedit.
3. Ekstre e në trap.
4. Në fund të fundit.
5. Janë fjetoret e ushtarëve
6. Parker regjisor.
7. Vivaldi kompozitor.
8. Një shkop për karambol.
9. Janë firmat rentiere.
10. Një i fundit mbi të gjithë
11. Kufizojnë tatimet

13. Janë nomadë.
15. Panik pa kufij.
16. Fryn detin
17. Sidney regjisori i Serpico.
18. Jep alarmin.
20. Fillojnë nazet.
24. Janë illogari.
25. Alan regjisor.
29. Roman regjisor.
32. Eshhtë X ajo e sulmit.
33. Kapen të parat.
35. Një provë... inteligjence.
37. Një markë lap top.
40. Fillojnë matjet.
41. Rruga e Ferenc Molnar.
42. Qerre pa qe.
45. Fillojnë lirinë.
46. Fillojnë vallen.
48. Në mes të dhomës.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Një doktor... i Fritz Lang
6. U paraprinë hoteleve.
11. Kush nuk ka... nuk ha
13. Eshhtë djall
14. Një mund të ketë i rrallë.
15. Ishin perëndi të Samotrakias.
17. Institucione Botuese Autonome.
18. Eshhtë infeksion në bark
20. Fundi i një samurai.
21. Një markë kafeje.
22. Mbyllin një hark.
23. Mund të jetë emërore.
25. Ishte muzikanti që nuk përsërite.
28. Në krye të avokatëve.
29. Qerre pa qe.
30. Një pjesë e adoleshentëve.
32. Një banor imagjinar i planetit të kuq.

VERTIKAL


1. James, armiku i Sherlock Holmes.
2. Eshhtë edhe ajo saudite.
3. Imami aktore
4. I kanë çift turket.
5. Inicialet e Seagal aktor.
6. Eshhtë dëshmore... çuditërisë.
7. Në fund të lutjes.
8. Eshhtë sporti me stil të lirë.
9. Mbeten në fund.
10. Eshhtë rasti i veçantë, karakteristik.
12. Conan ai i Schwarzenegger.
13. Gjysmë ditari.
15. Mario, që qe bomber argjentinas.
16. Mund të prishej nga një... kleçkë.
18. Në hyrje të pistës.
19. Një numër... femrash.
21. Eshhtë qyteti i Besës
24. Qyteti që quhej edhe Sebaste.
26. Njëlljo për latinët.
27. Mund të bëjnë stil të lirë.
31. Damon aktor.
33. Eshhtë pije e jona.
34. Në krye të noterëve.
36. Film i Robert Altman.
38. Skuadra merengue.
39. Një pjesë e hasmërisë.
40. Rralë është përgjysmë.
42. Nisur pa kufij.
45. Fillojnë mobilizimin.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

8			1	2	4	9		
9	1	2		8				
1			6	3	8	9		
						1	7	
		7	5			3	2	
	3			6	5		8	
4							6	
	9							

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	3	4	9	5	8	2	1	7
1	7	9	2	6	3	5	8	4
5	8	2	7	1	4	9	3	6
4	9	8	3	7	1	6	5	2
7	6	1	5	8	2	3	4	9
2	5	3	4	9	6	1	7	8
8	2	7	1	3	9	4	6	5
9	1	5	6	4	7	8	2	3
3	4	6	8	2	5	7	9	1

Argëtim filozofik

- Do të ketë gjithmonë njerëz që do t'ju lëndojnë, kështu që duhet të vazhdoni të keni besim, por duhet të jeni të kujdesshëm. Gabriel García Márquez
 - Jeni ajo që bëni, jo ajo që do të donit të bëni. Jeni veprat tuaja dhe jo mendimet tuaja - Carl Jung
 - Ata që nuk mund të qeshin me veten e tyre, ia lënë këtë punë të tjerëve.



KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

6	2	9	13	15	11	7	2	1	11	2	7	I	R	S	E	R	B	B	I	D	E	T
4	9	12	4	11	2	14	13	15	8	2	B	E	L	A	M	I	S	R	N	I		
1	11	2	12	4	2	12	4	11	6	1	8	I	I	H	I	P	O	T	E	Z	A	T
4	11	2	5	10	3	1	15	12	2	Z	P	A	R	A	K	A	L	I	M	E	T	
7	4	12	5	10	3	4	6	1	7	2	12	A	N	E	T	A	R	E	T	L	A	A
3	5	10	3	1	14	4	6	1	R	I	T	I	U	I	T	A						
4	12	2	5	1	7	2	12	11	4	3	A	T	E	E	M	T	A	I	R	O		
7	10	6	10	14	4	8	12	10	7	4	K	E	N	E	T	E	I	T	A	K	A	
12	11	1	9	4	12	6	8	5	15	5	T	K	D	T	E	A	N	T	A			
1	12	11	15	12	15	1	12	1	14	U	N	I	O	N	M	R	T	K				
7	2	14	4	12	7	K	O	S	H	3	A	I	M	I	S	I	O	N	A	R	E	T
4	12	1	7	9	4	7	9	4	11	4	L	K	S	T	U	R	I	S	T	E	T	

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Ehënie të mençura

- Mos lejoni që valët të të nxjerrin atje ku
- ato duan. Shih si lëvizin, dhe harto
- drejtimin tënd.
- Gjithçka që kërkohet është një mundësi për të treguar se paratë nuk më bëjnë të
- lumtur.
- - "Çdo ditë ngrihem dhe shikoj listën e
- "Forbes" për njerëzit më të pasur. Nëse
- nuk jam atje, shkoj në punë".

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

